

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



Ekstrakt nga Procesverbal, mbledhja e tretë e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, e mbajtur me datën 18.03.2026, në ora 10:00h, në sallën e Kuvendit të Komunës.

Anëtarët e Kuvendit të Komunës: Vlonjat Hasani - Kryesues i Kuvendit të Komunës, Festim Pllana, Daut Krasniqi, Kushtrim Mirena, Kosovar Ademi, Besarta Qadraku, Filloreta Musaj, Arlinda Mekolli, Rrahim Sogojeva, Hajredin Mjeku, Afrim Dumani, Laureat Gojnovci, Jetmir Berisha, Burim Berisha, Ali Topalli, Etnik Berjani, Saranda Sllamniku, Vjosa Kida Hyseni, Rrahim Tërnavë, Valon Murseli, Ermal Dumani, Aida Alimi, Dardane Sogojeva Shala, Migjen Kolshi, Suat Ademi, Dashnim Bajrami, Driton Ademi, Vildane Latifi dhe Radoman Doderovic.

Mungojnë: Mirlinda Krasniqi dhe Ali Ismaili

Prezentë nga Ekzekutivi i Komunës: Izja Mjeku - Drejtor për Shërbime Publike dhe Mjedis, Adriatik Zeqiri - Drejtor për Arsim, Durim Hajra - Drejtor i Inspektoriatit, Mirsad Qyqalla - Drejtor i Bujqësisë, Ylber Kelmendi - Drejtor i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Pranvera Merovci - Drejtoresha për Zhvillim Ekonomik, Bardhyl Kojcici - Drejtor për Buxhet dhe Financa, Taulant Kelmendi - Drejtor i Planifikimit Urban, Arianit Tërmkolli - Drejtor i Infrastrukturës dhe Valentin Krasniqi - Udhëheqës i Sektorit të Kadastrit.

Të tjerë: Përfaqësues të Shoqërisë Civile dhe Media.

REND DITE

1. Betime i anëtarit të ri të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës.
2. Aprovimi i Ekstraktit të Procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës e datës 18.02.2026.
3. Pyetje dhe Përgjigje parlamentare.
4. Propozim për emërimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale - Fushë-Kosova.
5. Propozim për caktimin e lokacionit për objektin e Ndërmarrjes Publike Lokale - Fushë-Kosova në fshatin Miradi e Poshtme.
6. Propozim për lejimin e mjeteve financiare për ndërtimin e objektit për funksionimin e Ndërmarrjes Publike Lokale - Fushë-Kosova.
7. Propozim për shqyrtimin e Bashkëpunimit operacional për Ndërmarrjen Publike Lokale - Fushë-Kosova dhe shërbime tjera me UNDP-në.
8. Propozim për ndërrimin e destinimit të objektit shëndetësor në fshatin Graboc i Poshtëm.
9. Propozim për lirimin nga pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në jo bujqësore për projektet publike.
10. Propozim për caktimin e anëtarëve të Komisionit Komunal për emërtimin e rrugëve.
11. Propozim për shqyrtimin e raportit të Komisionit Komunal për vërshimet e muajit janar 2026.
12. Raporti i Punës së Kuvendit të Komunës në vitin 2025.
13. Rishqyrtimi i vendimit Nr. 17, për shfrytëzimin e Zyrës Sektoriale për Stacionin e Policisë së Fushë Kosovës.

14. Propozimi për caktimin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për Projekt-Rregulloret.
15. Shqyrtimi i parë i Projekt-Planit Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore për vitet 2026-2028.
16. Propozim për miratimin e zgjerimit të projektit për instalimin e pompave termike në institucionet edukativo-arsimore në Komunën e Fushë-Kosovës.
17. Asociacioni i Komunave të Kosovës, për ti emëruar 3 anëtar të kuvendit të komunës si anëtar të Asociacionit të Komunave të Kosovës.
18. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Përshendetje për të gjithë, po e hapim zyrtarisht mbledhjen e tretë të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, besoj të gjithë e keni pranuar materialin dhe rekomandimet nga Komiteti për Politikë dhe Financa. Pa humbur kohë po lexoj pikat e rendit të ditës, që do t'i paraqesim sot në Kuvend për shqyrtim dhe vendim marrje. Pika e parë është Betimi i anëtarit të ri të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, pastaj është Aprovimi i Ekstraktit të Procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës e dates 18.02.2026, Pyetje dhe Përgjigje parlamentare, Propozim për emërimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale - Fushë-Kosova, Propozim për caktimin e lokacionit për objektin e Ndërmarrjes Publike Lokale - Fushë-Kosova në fshatin Miradi e Poshtme, Propozim për lejimin e mjeteve financiare për ndërtimin e objektit për funksionimin e Ndërmarrjes Publike Lokale – Fushë-Kosova, Propozim për shqyrtimin e Bashkëpunimit operacional për Ndërmarrjen Publike Lokale - Fushë-Kosova dhe shërbime tjera me UNDP-në, Propozim për ridestinimin e lokacionit për ndërtimin e Cerdhes së Fëmijëve në Fushë-Kosovë, është tërhyq nga ana e Ekzekutivi të Komunës, si rekomandim i komitetit, Propozim për ndërrimin e destinimit të objektit shëndetësor në fshatin Graboc i Poshtëm, Propozim për lirimin nga pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në jo bujqësore për projektet publike, Propozim për caktimin e anëtarëve të Komisionit Komunal për emërtimin e rrugëve, në këtë pikë, shtohet emri i Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Propozim për shqyrtimin e raportit të Komisionit Komunal për vërshimet e muajit janar 2026, Raporti i Punës së Kuvendit të Komunës në vitin 2025, Rishqyrtimi i vendimit Nr. 17, për shfrytëzimin e Zyrës Sektoriale për Stacionin e Policisë së Fushë-Kosovës, Propozimi për caktimin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për Projekt-Rregulloret, këtu duhet të shikoni rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, që kanë ardhur, i kemi shtuar anëtarët e subjekteve politike, me synim të gjithëpërfshirjes, Shqyrtimi i parë i Projekt-Planit Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore për vitet 2026-2028, pastaj propozimi tjetër, që ka ardhur si rekomandim nga Komiteti për Politikë e Financa, është kërkesë për projektin e instalimit dhe zgjerimin të pompave termike në institucionet edukativo-arsimore në Komunën e Fushë-Kosovës dhe tjetra është caktimi i tre përfaqësuesit nga Kuvendi ynë në Asociacionin e Komunave të Republikës së Kosovës dhe Të ndryshme, kemi një propozim për ndërrimin e anëtarit të Kuvendit dhe plotësimin e Komitetit për Komunitete, me përfaqësuesin e komunitetit egjiptian. Po e hapim diskutimin për këto pika të rendit të ditës dhe rekomandimet, që kanë ardhur nga mbledhja e Komitetit për Politikë e Financa, po fillojmë nga Lëvizja Vetëvendosje, nëse keni diçka për të shtuar?

Kosovar Ademi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje, nuk kemi diçka për të shtuar, e përkrahim aprovimin e rendit të ditës dhe rekomadnimet e ardhura nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Laureat Gojnovci: Faleminderit Kryesues i Kuvendit të Komunës, përshëndetje për të gjithë të pranishmit, fatmirësisht nuk shkruaj fjalime për Kuvendin e Komunës, sepse ish dashur të shkruaj i nderuari Kryetar i Komunës, Nënkryetar i Komunës, por sot nuk janë prezentë, që është për keqardhje, sepse mungesa e tyre e bën Kuvendin të mos ketë mbarëvajtje të mirë. Sa i përket rendit të ditës Kryesues i Kuvendit, edhe dje e kam propozuar në komitet që të trajtohet hapja e procedurave për caktimin e lokacionit për ndërtimin e shkollës në fshatin Lismir, dje në komitet nuk mora përkrahje, andaj sot ju kërkojë të gjithëve që ta përkrahni këtë pikë, ta fusim në rend dite dhe të diskutojmë, arsyeja është shumë urgjente, sepse në muajin shtator ata nxënës do të detyrohen të transferohen në një shkolle tjetër, ajo shkollë ka trashëgimi kulturore, është një ndër shkollat e para në Komunën e Fushë-Kosovës dhe nuk e dime, pse po doni me anuluar atë vendim për mos ta ndërtuar shkollën, është e domosdoshme për ata banorë, sepse ne mendojmë të rrisim fëmijët aty. Kërkojë nga ju që të futet në rend dite kjo pike, ndërsa për dy pikat tjera të rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, nuk kanë asnjë urgjencë. Pika e cila vjen për Asociacionin e Komunave, i ka ardhur Kryetarit të Komunës, me 11 shkurt 2026, kemi mundur ta trajtojmë në mbledhjen e kaluar, ndërsa për pompat termike nuk është urgjente, të gjitha shkollat janë të përfshira, përveç shkollës së Lismirit, arsyeja po dihet atë shkollë po doni ta mbyllni. Ju ftoj edhe njëherë ta votoni dhe ta fusim si pikë për shqyrtim në rendin e ditës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit z. Laureat Gojnovci, e çuditshme puna e fjalimeve tuaja, keni filluar me lexuar edhe vendime. Nga Partia Demokratike?

Migjen Kolshi: Faleminderit Kryesues i Kuvendit të Komunës, përshëndetje për të gjithë sa i përket kërkesës së z. Laureat Gojnovci, ne si Parti Demokratike e Kosovës pajtohemi, besoj se edhe buxheti është i ndarë për atë shkollë nga Bashkësia Islame, tani Kryesues i Kuvendit, te pika për propozimin e emërimit të Komisionit Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale - Fushë-Kosova, këtu mendoj, që e keni bërë me tendencë, sepse për derisa Lëvizjes Vetëvendosje, i është caktuar një anëtarë, mendoj se është dashur t'i caktohet edhe Partisë tjetër, pa marrë parasysh se cilës parti i takon. Shumë mirë keni bërë, te pika e shtatë - Propozimi për ridestinimin e lokacionit për ndërtimin e çerdhes së fëmijëve në Fushë-Kosovë, që e keni tërheq nga pika e rendit të ditës, sepse kompania e cila ka fituar tenderin për ndërtimin e atij objekti, ka të drejtë mos me vazhduar dhe 70% të projektit ta tërheq përmes Ligjit të Prokurimit, edhe vendi për ndërtimin e atij kopshti, ka qenë vend i papërshatshëm, sepse varrezat janë shumë afër.

Rrahim Tërnavë: Përshëndetje për të gjithë, pajtohem me propozimin e Laureatit, në atë shkollë, ku mësojnë sot nxënësit është gjendja e mjerueshme, për njëzet e pesë vite ka pasur mundësi dhe buxhet të ndërtohet dhe sot ka mundësi me u ndërtuar, edhe në Lismir, edhe në Nakaradë, të merret parasysh aspekti i sigorisë së nxënësve me rrugëtimi mbi urë të Lismirit e me ardhur në Nakaradë, për me shkuar në shkollë, kjo nuk është në rregull. Të merret parasysh se ajo shkollë, e ka histori të veçantë kur krejtë shkollat kanë qenë të mbyllura, ajo ka qenë aktive e mbajtur me shumë vështirësi e me financa të banorëve të Fushë-Kosovës. Nëse është nevoja edhe do të protestojmë, që ajo shkollë të ndërtohet në Lismir, edhe në Nakaradë, sepse të dyjat janë të nevojshme, me largimin e asaj shkolle, vetem do të largohen edhe me shumë banoret e fshatit Lismir, që është një keqmenagjim i komunës për të ardhmen e fshatrave të Fushë-Kosovës, andaj plotësisht pajtohem

me propozimin e Laureatit. Propozimi për ndërtimin e objektit për Ndërmarrjen Publike Lokale në fshatin Miradi e Poshtme, çfarë studimi keni bërë, çfarë komunikacioni, ku janë hyrjet e daljet, a nuk është më lehtë të dërgohet në Lismir ose Nakaradë, ku shërbimet bëhen në qytet shumë më afër, se sa në fshatin Miradi të Poshtme, sa shërbime ka fshati Miradi e Poshtme, sa shërbime i marrin qytetarët në fshatin Miradi e Poshtme, mos të shkojmë qysh ka shkuar në të kaluarën, po duhet me ndryshuar, edhe në teren, edhe në vendime. Vendimet duhet të merren për të mirën e qytetarëve të komunës tonë, kështu që nuk pajtohem, me vendimin e ndërmarrjes publike, me dërguar në fshatin Miradi të Poshtme, ne kemi obligim të ju shërbejmë qytetarëve të Fushë-Kosovës, shkolla sot nuk është në rend të ditës, por në të ardhmen me u vendos për shqyrtim, ndërmarrja me u studiuar, edhe njëherë lokacioni, mendoni më logjikisht, më afatgjatë dhe merrni vendime.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit, më duhet të jap një sqarim për të gjithë të pranishmit, prej datës 4 dhjetor, kur zyrtarisht e kemi marrë mandatin e ri dhe ka filluar qeverisja nga Kryetari i Komunës z. Valon Prebreza, në asnjë moment nga askush, nuk është thënë se do të anulohet një shkollë, emri i shkollës u përdor politikisht nga kolegu Laureat, asnjëherë nuk është anuluar asnjë vendim për ndërtimin e shkollës, devijime mundeni me bërë, është e drejtë e juaja me folë dhe mendime janë të tuajat, por s'ka me u bërë shkollë, po anulohet një shkollë, ose nuk do të ndërtohet një shkollë është unë s'kam ndëgjuar, ne po tentojmë të bëjmë sa më shumë shkolla, por unë e kuptoj rolin opozitar, që është t'i përdorin fjalët e veta qysh dojnë, por për fat të mirë çdo qëndrim është publik dhe i paraqitur para qytetarëve dhe nuk ka mundësi që brenda Kuvendit të Komunës, të bëhen devijime të tilla. Ju kërkoj si Kryesues i Kuvendit të Komunës, që të ju përmbahemi pikave të rendit të ditës, për përmbajtjen e secilës pikë veç e veç, flasim kur të ju vjen radha.

Driton Ademi: Përshëndetje për të gjithë, kam një sugjerim sa i përket pikave të rendit të ditës, gjatë hartimit të pikave të rendit të ditës formulimi të jetë adekuat, i thjeshtë dhe të reflektojë materialin e përmbajtur. Materiali është shumë i cekët konkretisht, tek pika e gjashtë e rendit të ditës, që është bashkëpunimi operacional për Ndërmarrjen Publike Lokale - Fushë-Kosova dhe shërbimet tjera me UNDP-në, ju e dini që marrëveshjet në Kuvend vijnë të shkruara, shqyrtohen, analizohen dhe në fund miratohen dhe këtu unë nuk po mundem me kuptuar, kush me kënd do të bashkëpunoj, statusi i ndërmarrjes është Shoqëri Aksionare dhe në qoftë se, ka bashkëpunim operacional, kalon në nivel tjetër që është nivel korporativ dhe nëse merr pjesë në vendimarrje ose menagjim, mund të konsiderohet si pubiko-privat, këtu materiali mungon, formulimi i bashkëpunimit dhe kush me kënd bashkëpunon. Po edhe te pika e shtatë, mirë që është larguar, por duhet të votoj Kuvendi i Komunës për largimin e saj, pavarësisht rekomandimit të mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa dhe ka qenë formulimi i keq, përveç ridestinimit po flasim edhe për bartje të projektit që del në kundërshtim me hartimin e procesit buxhetor. Pra, përmbajtja e formulimit të pikave të rendit të ditës, të jetë analog me përmbajtjen e materialit.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit z. Driton Ademi, ashtu ishte edhe rekomandimi im në fillim, për përmbajtjen e pikave të rendit të ditës, do të flasim për secilën veç e veç.

Laureat Gojnovci: Kryesues i Kuvendit, tani vec sa keqpërdore me pozitën e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, duke paragjykuar arsyen për futjen e shkollës, në pikë të rendit të ditës, është e drejtë e anëtarëve të Kuvendit të Komunës, të propozojnë pika të rendit të ditës, e juaja është me qitur në votim, a kalon, apo jo është çështje tjetër. Edhe dje në mbledhjen e Komitet për

Politikë dhe Financa, ka pasur mungesë të Ekzekutivit të Komunës dhe e keni luajtur rolin e avokatit për këto vendime, tani Kryesuesi i Kuvendit, mos e merr barrën që nuk të takon, duke dhënë konstatime për neve, pse jepim pika të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit që ju përmbajte kohës, unë nuk thashë se nuk keni të drejtë të jepni propozime dhe kur dikush jep propozim për pikë të rendit të ditës, duhet të ofroj një material dhe do ta shqyrtojmë.

Kosovar Ademi: Përshëndetje për të gjithë, deshta të ndërlidhem me Shefin e Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosoavës, deshta të pyes, ku ka qenë ky kur është vendos impianti në atë zonë, mbi atë impiantë është planifikuar një shkollë, të cilën t'i e dinë që është hipokrizi, që dy projekte të shkojnë në një lokacion, ose nuk e keni pasur seriozisht, kur e keni menduar impiantin ose nuk e keni pasur seriozisht kur e keni menduar shkollën. Këtu nuk ka sinjeritet, po bëni konsum politik para kamerave për banorët e zonës atje, kinse unë u përkujdesa për të drejtat e juaja, e kundërta ka ndodhë në dy mandatet e kaluara. Është dashur ta mendoni në kohën kur e keni pasur pushtetin, jo sot sa për konsum politikë, me tentuar me bërë goditje nga opozita.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit, meqenëse diskutimet përfunduan, po e hedhim në votim: Propozimin e Lidhjes Demokratike të Kosovës, kush është 'për' propozimin e paraqitur nga z. Laureat Gojnovci.

U votua me: dymbëdhjetë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe katërmëdhjetë abstenime
Në bazë të rezultatit të votimit konstatohet, që ky propozim nuk kalon.

Atëherë kush është për pikat e rendit të ditës, me rekomandimet e ardhura nga mbledhja e Komitetit për Politikë e Financa, duke marrë parasysh edhe tërheqjen e pikës së shtatë, si dhe përfshirjen edhe të Betimit të anëtarit të ri të Kuvendit të Komunës.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e nëntë anëtarë.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi që miratohet rendi i ditës, me rekomandimet e ardhura nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, tërheqjen e pikës së shtatë dhe pikën shtesë Betimin e anëtarit të ri të Kuvendit të Komunës.

Pika e parë (1) - Betimi i anëtarit të ri të Kuvendit të Komunës së Fushë Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Sipas ligjit do ta formojmë Komisionin për zhvillimin e procedurës prej tre anëtarëve, ftoi përfaqësuesin e Lëvizjes Vetëvendosje, që ta jap propozimin.

Kosovar Ademi: Në emër të Grupit Parlamentarë të Lëvizjes Vetëvendosje, e propozojmë znj. Arlinda Mekolli.

Laureat Gojnovci: Në emër të Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, e propozojmë z. Jetmir Berisha.

Përfaqësuesi i Partisë Demokratike të Kosovës: Ne e propozojmë z. Ermal Dumani.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Atëherë anëtarët e Komisionit të dalin jashtë dhe të bëjnë verifikimin e mandatit. Pas punës dhe verifikimit nga komisioni, në emër të Komisionit për verifikimin e mandateve, e ftoi të nderuarën znj. Arlinda Mekolli, të na jep verdiktin e komisionit.

Arlinda Mekolli: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, komisioni për verifikimin e mandateve, vlerësoi materialin zgjedhor, vendimin e datës 12.03.2026 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe listën e pjesëmarrësve në zgjedhje nga subjektet politike në Fushë-Kosovë, për zgjedhjet e 12 Tetorit 2025, për Kuvendin e Komunës, ku vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, thekson se z. Suhat Ademi emërohet anëtar i ri i Kuvendit të Komunës në Fushë-Kosovë, nga subjekti

politikë Partia Liberale Egjiptiane, duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit të Komunës z. Bashkim Krasniqi. Andaj janë plotësuar kushtet ligjore dhe formale që z. Suhat Ademi, ta lexoj dhe nënshkruaj Deklaratën e Betimit.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit znj. Arlinda Mekolli, ftojme z. Suhat Ademi, që ta lexoj Deklaratën e Betimit dhe në fund të theksoj fjalën 'Betohem'.

Suhat Ademi: Përshendetje për të gjithë, unë Suhat Ademi betohem se do t'i kryej me nder, besnikëri, pa anime e me ndërgjegje, sipas ligjit detyrat dhe do t'i ushtroj autorizimet e mia si anëtarë i Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, në mënyrë që të sigurohen kushtet për jetë të qetë për të gjithë. Betohem.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit, urime koleg ju dëshiroj suksese dhe punë të mbarë në punimet e Kuvendit të Komunës në Fushë-Kosovë, nga ky moment ju keni të drejtë vote.

Pika e dytë (2) - Aprovimi i Ekstraktit të Procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës e datës 18.02.2026.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Po e hapi diskutimin kush ka dicka të thotë?

Kosovar Ademi: Mendojmë që duhet të rregullohet.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit z. Kosovar Ademi, meqenëse nuk ka dikush tjetër të diskutoj e hedhim në votim, kush është 'për' aprovimin e ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës e datës 18.02.2026?

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej tridhjetë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstaton që kalon 'Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës i datës 18.02.2026.

Pika e tretë (3) - Pyetje dhe Përgjigje Parlamentare.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Po e hapi diskutimin, për parashtrimin e pyetjeve parlamentare.

Laureat Gojnovci: Faleminderit Kryesuesi i Kuvendit, edhe pse Kryetari i Komunës dhe Nënkryetari i Komunës, nuk janë prezentë unë do t'i parashtoj pyetjet, çështja e parë që dua të adresoj ka të bëjë me përndjekjen e punëtorëve-zyrtarëve komunal, që po bëhet nga ky Ekzekutiv i Komunës, deri sa ne jemi duke mbajtur mbledhje disa zyrtarëve i'a janë larguar paisjet dhunshëm nga zyra dhe dihet pse bëhet kjo punë, sepse kanë qenë pjesë e Ekzekutivit të pushtetit të kaluar. Është për keqardhje që këta zyrtar keqtrajtohen në vendin e tyre të punës, që e kanë të garantuar me ligj, do doja të ballafaqohesha me Kryetarin e Komunës ose Nënkryetarin e Komunës, sepse Drejtori i Administratës ka dhënë dorëheqje, arsyet nuk i di, por le ta dinë qytetarët që zyrtarët në këtë komunë po përndjekën për arsye të bindjeve politike. Edhe zyrtarët e tjerë maltretohen ose kërcënohen me ndryshim të vendit të punës. Neve si Kuvend i Komunës, duhet të na vie keq që jena pjesë e kësaj kohe në të cilën po ndodhë por na keni këtu për të adresuar çdo çështje. Drejtori i Planifikimit Urban e ka bërë një pezullim të lejeve, mbas tre jave e ka pezulluar aktvendimin që e ka nxjerr vetë, ose është ngutur, ose ka pasur qëllime tjera, që me i'u treguar që tani drejtor është Taulant Kelmendi dhe gjithë çka duhet të shkojë përmes tij. Drejtorin e Buxhetit dhe Financave nuk po e shoh, jemi po thuaj se komuna e vetme, që nuk e kemi bërë bartjen e të hyrave të pa shpenzuara në muajin shkurt, tani jemi në muajin mars, në prill duhet me sjellë, se mbesin të pa shpenzuara. Drejtori i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, pse nuk kanë filluar punimet në Stadiumin e

qytetit në Fushë-Kosovë, kur kontrata është kornizë dhe buxheti është hapur. Për Drejtorin e Drejtorisë së Arsimit, a jeni në dijeni që në gjimnazin 'Hivzi Sylejmani' nuk ka mësimdhënës të matematikës për një muaj e gjysëm, ligji thotë që nëse 30% e orëve humbin viti shkollorë, duhet të përsëritet dhe pyetja tjetër drejtor, a keni angazhuar ju disa mësimdhënës në shkollën 'Daut Bogujevci' dhe 'Mihal Grameno' Aneksi 2 në Fushë-Kosovë, me Karitas pa procedura të rekrutimit, nëse ka ndodhë një gjë e tillë, a është anti ligjore. Prapë për Drejtorin e Arsimit, a është lëshuar në funksion çerdhja e cila u patë inauguruar nga Kryeministri i Kosovës, nëse nuk është lëshuar në funksion, pse nuk është lëshuar. Po dua me adresuar një çështje, që ka të bëjë me automjetet zyrtare, që po përdoren jashtë orarit të punës, a janë lejuar nga Kryetari i Komunës, apo i marrin vetë drejtorët. Çështja tjetër ka të bëjë me shkollën në Lismir, dua t'i përgjigjem kolegut nga Lëvizja Vetëvendosja, është mandati im i dytë dhe kur është bërë 'Projekti i impiantit është bërë nga Ministria të cilën e udhëheq Lëvizja Vetëvendosje', ata nuk e kanë pyet as komunën, as Kryetarin e Komunës, e aq më pak mua, por prapë mendoj që është projekt i mire, sepse e zgjidh përfundimisht çështjen e e lumenjëve të Fushë-Kosovës, kështu që mos paragjykon.

Migjen Kolshi: Faleminderit Kryesues i Kuvendit, para se të filloj me pyetje, pata një kërkesë për Kryetarin e Komunës, Nënkryetarin e Komunës dhe Drejtorin e Buxhetit dhe Financave, për dy organizatat e dalura nga lufta, kemi pasur takim me përfaqësuesit e këtyre organizatave dhe kanë nevojë për ndihmë financiare, do të ishte mirë të ndihmohen dhe të kanë një kod buxhetor, sepse disa komuna e kanë bërë këtë. Tani po filloj me pyetje, pyetja e parë është për Drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, kur do të fillojnë punimet në ujësjellësin e fshatit Harilaç. Për Drejtorin e Administratës, a kanë të drejtë punëtorët e komunës konkretisht Drejtorët e Drejtorateve, Nënkryetari i Komunës për Komunitete, me i marrë automjetet zyrtare jashtë orarit të punës. Prapë për Drejtorin e Administratës, punëtorët e projekteve të 'Karitasit dhe Kosova Med', a janë të pajisur me bexh, kur vijnë në punë, a lajmërohen. Për Drejtorin e Planifikimit Urban, e pata të njejtën pyetje si z. Laureat Gojnovci. Për Drejtorin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, gjendja e Klubit Futbollistik 'Fushë-Kosova', është kogja e rëndë, si drejtor a keni paraparë diçka me ju ndihmuar, sepse me sa e di, e keni dërguar një punëtorë aty.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit z. Migjen Kolshi, sa për informate prej dhjetorit deri tani, ka kaluar koha kur punëtorët kanë marrë paga pa punuar.

Migjen Kolshi: Këtë po e them për arsye, deri sa nuk po i jepni emërat kush është në punë, mendojmë se keqperdorni me vendet e punës, unë njoh persona që vijnë dy orë këtu punojnë dhe marrin pagë dikun tjetër.

Dardane Sogojeva Shala: Faleminderit Kryesues i Kuvendit të Komunës, përshëndetje për të gjithë. Kryesues disa drejtorat janë shumë arroganta, për Drejtorin e Drejtorisë së Inspektoratit, parkingjet të shkolla, kur do të lirohen, sepse fëmijet nuk kanë nga të lëvizin. Drejtori i Arsimit me datën 20.08.2025, konkursi i mësimdhënësve, aplikuesit e kanë kryer testin dhe janë pranuar, pse është pezulluar pjesa e tyre. Drejtorin e Inspektoratit, e falenderojmë për punën që jeni duke e bërë në qytet, që ky objekt që është duke u ndërtuar afër shtëpisë së Kryetarit të Komunës, a ka leje ndërtim dhe a është hapësira prej trotuarit e larguar. Për Kryetarin e Komunës nuk po bëjë pyetje, sepse nuk është këtu dhe nuk po kthen email. Për Drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, kur doni me vepruar me trotuare nëpër fshatra dhe nëpër qytet, a keni ndonjë plan për t'i rregulluar dhe tek çështja e ujit, pse banorët nuk kanë ujë.

Valon Murseli: Faleminderit Kryesues i Kuvendit, përshëndetje për të gjithë, disa nga kërkesat e qytetarëve, bizneseve por edhe bujqëve, po i prezantoj si në vijim: Kërkesa që Kuvendi i Komunës të nxjerr një vendim, që të liroi nga taksa për leje ndërtimore të gjithë fermerët e Komunës së Fushë-Kosovës, kur aplikojnë për ndërtimin e objekteve bujqësore si: stallat për bagëti, objektet për shpeztari, objektet për ruajtjen dhe konservimin e frutave dhe perimeve, si dhe serrat që ndërtohen me donacione publike apo me buxhet vetanak. Këtë praktikë e bëjnë tashmë disa komuna, andaj kërkojë që kjo kërkesë të merret parasysh, në këtë rast duhet të bëhet plotësim-ndryshim i Rregullores për tarifa dhe gjoba, është mirë që kjo rregullore të procedohet në Kuvendin e Komunës për secilin vite. Kërkesa tjetër për bujq është mbështetja me mekanizëm bujqësor, është mirë që fermerët që kanë lopë qumështore të mbështeten me paisjen laktofriz nga komuna, po edhe nga niveli qendror, sikurse suvencioni për cilësi të qumështit që këta fermerë të kenë mundësi të ruajnë qumështin dhe të përfitojnë suvencione nga niveli komunal dhe qendror, duke përfshirë subvencionimin e cilësisë së qumështit. Kërkesë tjetër është pastrimi i rrugëve dhe trotuareve, pasi që gjendja është e rëndë dhe kërkohen masa në mënyrë që të mbrohet shëndeti i qytetarëve, andaj kërkoj që buxheti i paraparë për ndërtimin e Ndërmarrjes Publike Lokale të shfrytëzohet për blerje të makinerisë për larjen dhe mirëmbajtjen e rrugëve. Për ndërmarrjen, mendoj mund të shfrytëzohet objekti i TrainKos Sh.A, i cili është afër qytetit dhe mund të merret me qera, po ashtu pajtohem me z. Rrahim Tërnavë, që ky objekt nuk është mirë të ndërtohet në atë zonë. Shumë qytetarë pyesin për leje ndërtimore, çka po ndodh me to? A janë të sigurt investimet që kanë bërë dhe a janë të sigurt të blejnë banesa? Nënkryetari i Komunës ka thënë që disa ndertues janë duke ndërhyrë po zbuten, është mirë me ditë kush u zbut dhe cila ishte formula që u zbuten? Pyetje tjetër pas aprovimit nga Qeveria dhe Kuvendi të Buxhetit të vitit 2026, sa mjete financiare janë planifikuar për rrugën përgjatë Hekurudhës, a është në kuadër të shpronësimit, ndërtimit dhe kur do të zhvillohet ky projekt? Për Drejtorin e Drejtorisë së Inspektoriatit, te ngastrat kadastrale te 'Britania Home', rruga '28 Nëntori', nuk është marrë asnjë masë për largimin e atyre garazhave dhe një objekti tjetër që është aty, pse nuk merren masa në atë hapësirë? Në kuadër të investimeve në infrastrukturë, kërkohet që të ndërhyhet në rrugën 'Edit Durham' një rrugë jo shumë e gjatë përball komunës, e cila është dëmtuar gjatë punimeve në Hekurudhë. Po ashtu në fshatin Vragoli, kërkohet pastrimi dhe largimi i mbeturinave, në rrugën 'Avdullah Pllana', largimi i dheut dhe Nakaradë. Kërkesë e banorëve në rrugën 'Dardania', ndërrimi i vendeve të kontejnerëve, pasi që është rrezik për ata banorë, nëse ka ndonjë zjarr, kërkesa tjetër është që të ketë projekti ekspozim në rrugën 'Dardania', që besoi, që është e drejtë ligjore dhe të kemi një përgjigje, se kur do të përfundojnë këto punime dhe të ketë një inspektim më të madh për këto punime. Kërkesë tjetër për Drejtorin e Inspektoriatit, është të bëhet një kontrollim i objekteve banesore publike dhe kolektive për aparate kundër zjarrit, është mirë kur të bëhet pranimi teknik, të merren numrat serik të këtyre aparateve, në mënyrë që të mos keqpërdoren dhe mos të vihet në rrezik jeta e qytetarëve. Kërkesë tjetër është rreth procesit të legalizimit, është mirë që të punohet më shumë në këtë drejtim, të lirohet kapitali i qytetarëve. Është premtuar nga Kryetari i Komunës, që do të ketë transparencë në shpenzime, por nuk po shoh që ka transparencë, këto janë disa nga kërkesat e mia.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit shumë, sa i përket rregullores për tarifa dhe gjoba, e kemi sot në rend të ditës dhe do t'i përcaktojmë anëtarët.

Aida Alimi: Faleminderit Kryesues i Kuvendit, përshëndetje për të gjithë, pyetja është për Kryesuesin e Kuvendit të Komunës, kur do të jenë funksional mikrofonat në sallën e Kuvendit,

kërkoj që edhe zërimi të jetë pak më i mirë, pyetja tjetër është, a keni menduar ndonjë plan ose strategji për largimin e qenëve endacak të cilët janë rrezik permanentë për qytetarët e Fushë-Kosovës. Drejtorin e Inspektoratit z. Durim Hajra, e përgëzoi për punët e mira që i ka bërë në terren dhe dua ta pyes, kur do ta lirojnë hapësirën përball Stadiumit të Qytetit. Drejtorat në fund i njoftoj, që ne nuk jemi rastësisht në sallën e Kuvendit, kemi kaluar një proces të zgjedhjeve, zgjedhjet e ardhshme vijnë prapë, këtu vijmë ne, vini edhe ju njëherë në muaj, sikur edhe ne këtu, andaj duhet të kemi konsideratë për çështjet, që ne i ngrisim për diskutime dhe sqarime.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Falemienderit znj. Aida Alimi, mikrofonët do të jenë funksional kur të bëhet renovimi i sallës, që i kena nis disa procedura fillestare, kërkesa e koleges është me vend që të mbajmë qetësi, e ne do të kujdesemi, që zërimi të jetë më i mirë.

Ali Topalli: Përshëndetje për të gjithë, kam tre pyetje e para për juve Kryesues i Kuvendit të Komunës, a do të kemi përgjegje në pyetjet e Anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, prej Kryetarit të Komunës, Nënkyetarit të Komunës, apo prej Drejtorave të Drejtorateve? Pyetja e dytë sot, ka ndodhë një arrogancë e pa parë me disa zyrtarë të komunës, që janë nga Lidhja Demokratike e Kosovës, dua të pyes Kryetarin, Nënkyetarin dhe juve Kryesues, këta zyrtarë që sot janë larguar dhunshëm nga vendet e punës, këta zyrtarë, a'u zënë në flagrancë diçka apo me çfarë baze ligjore u larguan sot nga vendet e punës, mos ndoshta keni marrë ndonjë direktivë nga ajo 'Kësulkuqja' atje që zakonisht jep udhëzime. Kam edhe një pyetje për Drejtorin e Planifikimit Urban, a më lejoni me kontaktuar ndonjë zyrtar të urbanizmit, a më lejoni me hyrë në drejtori apo jo?

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit koleg, me gjithë respektin unë, po i përmend tre fjalë që i përdore brenda kohës tende: 'Kësulkuqe, dhunshëm dhe arrogancë', edhe kolegu yt e përmendi fjalën 'Përndjekje', me sa di unë punëtorët shqiptarë, janë përndjek vetëm në kohën e luftës, kjo çka po e thuani ju është shumë e pa pranueshme.

Vildane Latifi: Faleminderit Kryesues i Kuvendit të Komunës, e mora fjalën për akuzat e bëra nga Shefi i Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, për dorëheqjen e Drejtorit të Administratës arsyjeja e dorëheqjes është personale. Në vitin 2021, kemi pasur marrëveshje me Lidhjen Demokratike të Kosovës, momentin që nuk e kemi vazhduar bashkëpunimin me ta, e kemi komunikuar në media. Ne për momentin kemi disa punë të brendshme që nuk ju interesojnë juve fare.

Laureat Gojnovci: E nderuara kolege, unë në asnjë moment nuk thashë, që arsyjeja e dorëheqjes së Drejtorit të Administratës z. Shefqet Zogaj, për të cilin kam respekt lidhet me presionin ndaj zyrtarëve publik. Arsyet e tij mund të jenë personale ose profesionale, të cilat unë i respektoi.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit shumë, z. Ali Topalli tha, a do të ketë përgjigje në pyetjet e Anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovë dhe përgjigjia është po do të ketë, për pyetjet ndaj Kryetarit të Komunës dhe Drejtorëve të Drejtorateve, përkujdesem që pyetjet t'i drejtoni edhe me shkrim.

Drejtori i Kulturës, Rinisë dhe Sportit: Faleminderit shumë i nderuar Kryesues i Kuvendit të Komunës, të nderuar asambleistë dhe musafirë, pyetja e parë ishte për Stadiumin së pari kam kërkuar një auditim komplet, sa i përket stadiumit, sepse ka keq-menagjim të jashtëzakonshëm, janë shpenzuar dikur 420,000.00€ vetëm për themel të stadiumit dhe mendojmë se është keq-menagjuar. Sa i përket Memorandumit me Federatën e Futbollit të Kosovës, keta e kanë shkëputur Memorandumin, sepse ka qenë një vendim i cili e lejon shkëputjen e këtij Memorandumi, pra ka

qenë investim prej Federatës të Futbollit 1.8 milion euro dhe duhej të ishte, në do të shikojmë mundëi tjera për ta mbështetur ndërtimin e stadiumit. Federata e Futbollit të Kosovës, thotë se nuk e kanë në agjendën e tyre, për të ndërtuar stadium, por vetëm fusha me bari sintetik. Sa i përket gjendjes së klubit, klubi është Organizatë Jo Qeveritare dhe ne nuk përfshihemi, ata e kanë të drejtën të bëjnë kërkesa në thirrje publike dhe ne pastaj, nëse kemi mundësi i subvencionojmë. Sa i përket punësimit të djalit të legjendës Ekrem Grajçevci, ai ka qenë i anashkaluar dhe ne kemi gjetur mundësinë përmes Karitasit ta punësojmë. Është një projekt në fshatin Sllatinë të Vogël, salla e sportit e cila është bërë një hapje solemne para zgjedhjeve, ndërkohë që salla nuk ka rrymë, si ka mundësi që Drejtori e ka pranuar hapjen solemne të sallës së sporteve në fshatin Sllatinë të Vogël, kur nuk i plotëson kushtet elementare, ne si Drejtori për Kulturë, Rini dhe Sport, duhet të mendojmë për trafo, e cila kushton rreth 40,000.00€. Në këtë qytet për njëzet e pesë vite, kultura e sporti kanë qenë të vdekura.

Drejtori për Shërbime Publike dhe Mjedis: Përhëndetje për të gjithë, z. Migjen ujësjellësi fillon javën tjetër, kontrata është dy vjeçare për 400 ditë pune, kur është dashur të jetë 180 ditë pune, sa i përket ujit të pijshëm, që nuk është lëshuar ka qenë problemi i rrymës dhe janë vonuar procedurat. Në qoftë se bëhet pranimi teknik nga KEDS-i, sot mundemi me lëshuar edhe nesër. Sa i përket pastrimit të rrugëve dhe trotuareve, ju e dini që ne kemi marrëveshje me Kompania Rajonale e Mbeturisë 'Pastrimi', me rreth 11 punëtorë, ata çdo ditë bëjnë tërheqjen e mbeturianve dhe pastrimin e rrugëve, e kemi rritur numrin e punëtorëve dhe tani me Ndërmarrjen Publike Lokale, po mendojmë t'i pastrojmë rrugët më shumë. Vendosja e pikave grumbulluese, unë kam kërkuar nga Drejtoria e Infrastrukturës që pranimet teknike t'i marrim për çdo objekt që ndërtohet dhe përmes një komisioni të përbashkët mes Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Kompanisë 'Pastrimi' dhe Drejtorisë së Infrastrukturës, do t'i vendosim aty ku është leja. Kontejner kemi të mjaftueshëm dhe vendosja do të bëhet në bazë të lejes teknike, që e ka marrë ai objekt.

Drejtori i Inspektoratit: Faleminderit Kryesues i Kuvendit të Komunës, të nderuar të pranishëm, ju falënderoj për pyetjet dhe ju inkurajoi, që më shtuar numrin e pyetjeve. Sa i përket pyetjes së znj. Dardane Sogojeva Shala, lidhur me parkingjet e parregullta afër shkollës, për këtë çështje janë dy probleme bazike, e para ka të bëjë me infrastrukturën ligjore dhe rregullative, e dyta me infrastrukturën fizike, që të dyja kërkojnë kohë, pjesa rregullative ju bjen juve barra si Kuvend i Komunës, që me rregulluar këtë çështje në mënyrë që ne të jemi ligjërish në rregull për të bërë veprime konkrete, në këtë rast për shqiptimin e gjobave ose shenjëzimin, ndërsa çështje fizike është problematikë, që i përket Drejtorisë së Infrastrukturës, pra Drejtoria e Inspektoriatit, nuk mundet me dhënë zgjidhje direkt në këtë rast. Pyetja e dytë ishte në lidhje me një objekt, unë sinjorisht pashe një imazh, nuk e di ku ndodhet shtëpia e Kryetarit të Komunës dhe ne nuk mundemi me intervenuar, pa e ditë saktë që ka shkelje të ligjit, kemi një gjendje të trashëguar, ku kemi mbi 7000 objekte pa leje kemi me u munduar me i dhënë zgjidhje me kohë. Pyetjet e anëtarit të Kuvendit të Komunës z. Valon Murseli, që ka të bëjë me disa garazha të Kompleksi 'Britania Home', tani janë liruar, mjetet dhe tani mundën me u nis procedurat për ta kontraktuar një kompani të rrënimit, sepse Inspektoriati nuk ka mjete për largimin e tyre. Sa i përket sigurisë në objektet shumëkatëshe, asnjë inspektim final nga Drejtoria e Inspektoriatit, nuk është bërë për objektet e reja, nuk është përgjegjësi e qeverisjes se re, se çka ka ndodhë më herët, e dyta përgjegjes për këto, që i adresove t'i është Agjensioni i Menagjimit të Emergjencave, ndërsa legalizimet nuk janë në

domenin e Drejtorisë së Inspektoriatit. Sa i perket pyetjes së znj. Aida Alimi, përgjigjia është e njejtë pa Kompaninë e rrëtimeve nuk mundemi të bëjmë asgjë.

Drejtori i Arsimit: Përshëndetje për të gjithë, i pata disa pyetje prej asambleistave Laureatit dhe Dardanes, në Gjimnazin 'Hivzi Sylejmani', nuk kemi mësimdhënës të matematikës, ishte pyetja a dini? Po e di, është një problem i një sistemi, që e kemi ndërtuar për shumë vite, i cili ka prodhuar disa profesione, por nuk ka menduar se vjen një ditë, që kemi me pasur nevojë për mësimdhënës dhe nuk kemi me i pasur, konkurse kemi shpallur vazhdimisht dhe nuk kemi pasur kandidat, unë nuk kam fajë, as t'i nuk ke fajë, kanë fajë subjektet politike që nuk kanë bërë programe adekuate dhe sot jemi kështu. Nuk kemi mësimdhënës të matematikës që sot të jap mësim në Gjimnazin 'Hivzi Sylejmani', pyetja tjetër ishte mësimdhënës në shkolla me Karitas, nuk ka mësimdhënës në shkolla me Karitas, janë disa asistente për fëmijë me nevoja të veçanta, kemi qenë të kujdesshëm, që të jenë të kualifikuara dhe që njohin natyrën e punës me fëmijë me nevoja të veçanta, një pjesë e tyre kanë qenë të angazhuara paraprakisht prej prindërve dhe ne ju kemi ndihmuar këtyre familjeve, duke ju lehtësuar barrën e shpenzimeve. Çerdhja e Fëmijëve tek shkolla 'Selman Riza', ju e dini që ka pasur probleme te projektimi për arsye se Ministria e Arsimit, na ka sjellë disa paisje për kuzhinë, të cilat nuk kane qenë brenda projektit të planifikuar, ne kemi kërkuar nga Ministria e Arsimit, që të bëjë zgjidhje që të mos ngarkoj buxhetin dhe qysh është duke shkuar dinamika e projektit, besoj që në prill ajo çerdhe do të jetë e gatshme. Dua të ndalem pak edhe te shkolla e Lismirit, e vetmja gjë që kemi bërë ne si Ekzekutiv i Komunës, është që kemi konsideruar, që ajo ngastër kadastrale nuk është e përshtatshme për shkollë dhe e kemi shfuqizuar. Nuk kemi me bërë asgjë pa diskutuar me komunitetin, sepse nëse bëhet një shkollë bëhet për atë komunitet. Sa i përket trotuareve që ishte pyetja nga znj. Dardanja, edhe unë të njejtën pyetje i'a kam bërë Drejtorit të Inspektoriatit, sa i përket konkursit thatë është anuluar konkursi, anulohet kur ka një vendim për anulim, që është publik. Konkursi nuk është anuluar, ai konkurs është mbajtur gjatë kohës së fushatës elektorale, pastaj ka ardhur Ekzekutivi i ri, aty ka pasur ankesë dhe une jam duke u kujdesur mos me i'a cënuar të drejtën asnjërës palë, kam kërkuar një opinion ligjor çka me bërë dhe kur te marrim opinionin ecim përpara, kjo është gjendja.

Migjen Kolshi: Faleminderit Kryesues i Kuvendit, tani drejtori z. Ylber Kelmendi, më duket se e keqkuptoi fjalën time, unë nuk thashë, që ka bërë keq që e ka punësuar atë djalë, kam vërejtje për sjelljen e tij, që nuk është si e drejtorëve tjerë, për njëzet e pesë vite, është punuar në sport dhe kulturë.

Laureat Gojnovci: Ne e kemi kuptuar realitetin dhe e dina, që jena në opozitë, por edhe si opozitë mundemi me dhënë kontribut për mirëqenien e qytetarëve. Këtu ngrisim çështje që janë në interes të qytetarëve, kur ka diskutim mes asambleistit dhe drejtorit, edhe Kuvendi shkon mbarë e mirë, por kur vjen Drejtori i Planifikimit Urban dhe Drejtori i Kulturës, që sillen me arrgancë, këtu është Kuvend dhe çdo mbledhje kanë me pasur pyetje nga Lidhja Demokratike e Kosovës, jemi të gatshëm me diskutuar, kur kemi përgjigje si të tre drejtorëve tjerë.

Drejtori i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural: Faleminderit Kryesues i Kuvendit të Komunës, përshëndetje për të gjithë, dua të përgjigjem në disa pyetje nga asambleisti z. Valon Murseli, sa i përket lejeve unë e mirëpres çdo vendim, që e merr ky Kuvend i Komunës, te pjesa e dytë, a kanë me u mbështet fermerët me laktofriz, ne kemi pasur një takim me fermer dhe ata, e kanë plotësuar një pyetësor për kërkesat e tyre primare, i kemi analizuar ato dhe laktofrizi nuk është që ka zënë shumë hapësirë në këtë pyetësor, sepse qumështi në komunën tonë është në rënie e sipër dhe për

këtë arsye kemi vendos me Kryetarin e Komunës, me mbështet me 7 cent për litër. Ne do të mbështesim çdo vendim nga ky Kuvend, që shkonë në favor të fermerëve.

Ali Topalli: Drejtorin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, e kam mik, kur e kam dorëzuar mandatin e drejtorit, e kam pritë në zyrën time, kemi biseduar gjatë, e kam dorëzuar një projekt, kemi bërë foto është bërë lajm dhe ata nalt kanë dhënë urdhër me e fshirë. Kryesues një pyetje për ty keni qenë anëtarë i Kuvendit të Komunës, a të kanë bërë drejtorat ndonjëherë pyetje në cilësinë e anëtarit të Kuvendit?

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Po, shumëherë, drejtorat dhe nënkryetari më kanë bërë pyetje, edhe pse kam qenë anëtar i Kuvendit të Komunës. E konstatojmë që është konsumuar kjo pikë e rendit të ditës.

Pika e katërt (4) - Propozim për emërimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale - Fushë-Kosova.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: I nderuari Drejtor z. Izja Mjeku, fjala për ju.

Drejtori për Shërbime Publike dhe Mjedis: Sikur e dijmë në bazë të vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të datës 20.02.2026, është marrë vendim për themelimin e Ndërmarrjes Publike Lokale - Fushë-Kosova, bazuar në Ligjin për Ndërmarrje Publike, këtu Drejtoria e Shërbimeve Publike, në konsultim me Kryetarin e Komunës, propozon emërimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale, ku dy anëtar emërohen nga Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës, një nga Lëvizja Vetëvendosje dhe një nga subjektet e tjera politike ndërsa i treti nga emërohet nga Kryetari i Komunës. Këta tre anëtarë, do të përfaqësojnë dhe mbrojnë interesat e qytetarëve të Komunës së Fushë-Kosovës, në kuadër të kësaj ndërmarrje.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit drejtor, hapi diskutimin, ftoi tani Lëvizjen Vetëvendosje, që e keni të drejtën e propozimit të një anëtar, emrin e juaj ju lutem.

Besarta Qadraku: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lëvizjes Vetëvendosje, për anëtarë të Komisionit Komunal të Aksionarëve, në Ndërmarrjen Publike Lokale - Fushë-Kosova Sh.a, e propozojmë z. Hajredin Mjeku.

Afrim Dumani: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, për anëtarë të Komisionit Komunal të Aksionarëve, në Ndërmarrjen Publike Lokale - Fushë-Kosova Sh.a, e propozojmë znj. Mirlinda Krasniqi.

Migjen Kolshi: Pse e keni definuar vetëm për lëvizjen Vetëvendosje, ndërsa për anëtarin e dytë, keni thënë një përfaqësues nga subjektet tjera politike, kjo punë nuk është në rregull.

Driton Ademi: Tani i kemi dy - tre pika që po ndërlihen me ndërmarrjen, besoj që e dini në vitin 2022, ne e kemi bërë një lloj kthese në kuptimin sektorial, sa i përket çështjeve organizative, kemi hequr dorë nga opertorët ekonomik dhe jemi përcaktuar për Ndërmarrjen Publike Lokale. Në atë kohë, sa i përket arsyeshmërisë nuk ka pasur diçka specifike, por në mënyrë të përgjithëshme, sa i përket realizimit të projekteve. Sa i përket aspektit të funksionimit në mënyrë të përgjithshme i kemi përmendur pastrimin e objekteve publike, hapësirat publike, parqet, ndriqimi publik e tjera, por në mënyrë specifike jo, e kemi bërë një kapital fillestar, një plan biznesi dhe kemi ardhur deri te vendimi dhe unë konsideroj që vendimi sot, është dashur ta ketë secili asambleist në tavolinë, si pjesë të materialit dhe këtu përmbyllet faza e parë. Sot vazhdojmë me pjesën e dytë, është konsolidimi i kësaj ndërmarrje, kështu që i'u bëjë thirrje si asamblesitë, që edhe Legjislativi, edhe Ekzekutivi, të japim maksimumin për funksionalizmin e kësaj ndërmarrje. Rëndësia e Komisionit

Komunal të Aksionarëve, është se komuna nuk qeverisë me Ndërmarrjen Publike Lokale, këtë e bën ky komision, prandaj nevojitet integritet dhe përgatitje profesionale. Ky komision do të emëroj Bordin e Drejtorëve, pastaj ai bord do të emëroj Drejtorin Ekzekutiv, vijnë procedurat e rekrutimit dhe Komisioni e obligon ndërmarrjen me hartuar statutin, rregullore, me na raportuar neve për pasqyrat financiare, prandaj ky komision është shumë i rëndësishëm. Unë sugjeroj ta keni parasysh çështjen e punësimeve, mos e ngarkoni me staf dhe propozoj të merret parasysh kuota gjinore.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit z. Driton Ademi për këtë diskutim substancial, i kemi dy propozime për komision z. Hajredin Mjeku dhe znj. Mirlinda Krasniqi, tani po i qesim në votim kush është 'për' këto propozime.

U votua me: njëzet e pesë vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej njëzet e pesë pjesëmarrës në votim.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se 'Propozimi për emërimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale - Fushë-Kosova, aprovohet dhe mori:

V E N D I M

1. Me këtë vendim bëhet emërimi i Komisionit Komunal të Aksionarëve prej Komunës së Fushë-Kosovës për Ndërmarrjen Publike Lokale – Fushë-Kosova, në përbërje si vijon:
 - 1.1 Hajredin Mjeku - përfaqësues nga Lëvizja Vetëvendosje, i emëruar nga Kuvendi i Komunës - anëtar;
 - 1.2 Mirlinda Krasniqi - përfaqësuese nga Lidhja Demokratike e Kosovës, e emëruar nga Kuvendi i Komunës - anëtare dhe
 - 1.3 Shpend Bardiqi - Nënkryetar i Komunës përfaqësues i emëruar nga Kryetari i Komunës - anëtar.
2. Detyrat, kompetencat dhe përgjegjësitë e këtij Komisioni janë të përcaktuara, me Ligjit për Ndërmarrje Publike Nr. 03/L-087, (Gazeta Zyrtare Nr. 31/2008) dhe dispozitave ligjore të Ligjit Nr. 04/L-111, për ndryshim-plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087, për Ndërmarrjet Publike (Gazeta Zyrtare Nr. 13/2012), i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-009, lidhur me Ligjin Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare (Gazeta Zyrtare Nr. 09/2018), ligjet dhe aktet tjera nënligjore në fuqi.
3. Mandati i Komisionit Komunal të Aksionarëve në Ndërmarrjen Publike Lokale - Fushë-Kosova, zgjat dhe është i ndërlidhur me mandatin zgjedhor të Kuvendit të Komunës.

Pika e pestë (5) - Propozim për caktimin e lokacionit për objektin e Ndërmarrjes Publike Lokale - Fushë-Kosova në fshatin Miradi e Poshtme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani e ftojme Drejtorin e Shërbimeve Publike z. Izja Mjeku, ta paraqes propozimin.

Drejtori i Shërbimeve Publike dhe Mjedis: Drejtoria për Shërbime Publike dhe Mjedis, në bashkëpunim me Drejtorin e Planifikimit Urban dhe Drejtorin e Pronës, në konsultim paraprak edhe me Kryetarin e Komunës, propozon caktimin e lokacionit për objektin e Ndërmarrjes Publike Lokale - Fushë-Kosova, në fshatin Miradi e Poshtme, me sipërfaqe S=22808m² dhe këtij propozimi i bashkangjitet edhe materiali në vazhdim. Ju ftoj ta votoni këtë propozim.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit drejtor, unë po e hapi diskutimin, ftoi Lëvizjen Vetëvendosje, që ta jap qëndrimin e saj lidhur me këtë propozim.

Kosovar Ademi: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lëvizjes Vetëvendosje, ne e përkrahim për aprovim 'Propozimin për caktimin e lokacionit për objektin e Ndërmarrjes Publike Lokale - Fushë-Kosova, në fshatin Miradi e Poshtme, me sipërfaqe S=22808m²'.

Laureat Gojnovci: Faleminderit Kryesues i Kuvendit, dhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, me drejtorin z. Izja Mjeku e kemi pasur një diskutim të gjatë dhe sot nuk dua ta ngarkoj drejtorin, me diçka që nuk është përgjegjës. Ne e kemi aktive një Hartë Zonale të Komunës dhe kjo hartë e parasheh atë zonë, që është zonë rekreative e turizmit, do të doja që Drejtori i Arsimit të na jep arsyetimin për vendimin e anulimit të shkollës në fshatin Lismir, arsyetimin Drejtori e dha, që është afër impiantit, e në Kuvendin e Komunës na ka ardhur një propozim, që nuk është në përputhje me Hartën Zonale të Komunës, ju po bëni kontradikta, po doni me e ndërtuar një zonë, që me hartën zonale është park. Ne nuk jemi kundër ndërmarrjes, por kundër hapave të cilët po ndërmirren, ju ftoj që të mos votoni këtë propozim, sepse është në kundërshtim me hartën zonale.

Rrahim Tërnavaj: Drejtor do ishte mirë me na u përgjigjë, a keni analizuar mirë shërbimet e kësaj ndërmarrje, sepse punët e mëdha kanë me qenë në qytet, sa kohë i duhet punonjësëve nga Miradia e Poshtme, me ardhur në lagjen 'Apollonia', sa kohë i duhet me u kthyer në punë d.m.th, sa kohë humbë vetëm me transport, ne nuk jemi për ngut që të ndërtohet objekti, ai mundet të merret ndonjë objekt me qera, ose të kërkohet ndonjë pronë tjetër më afër qytetit, ne nuk jemi kundër ndërmarrjes, përkundrazi e përkrahim dhe e dime, se është urgjente të ndërtohet, por ju lutem mendoni, edhe njëherë lokacionin, sepse është një vendim afatgjatë.

Driton Ademi: Nëse ne vendosim me qitë pengesa në ndërtimin e ndërmarrjes, atëherë kjo dështon, unë propozoj një lloj ridestিনিimi për hapësirën.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit z. Driton Ademi, lokacionin që e kemi propozuar për ndërmarrjen, është vendi më i përshtatshëm që kemi mundur me gjetë prej pronave, që i kemi në posedim, është një hulumtim i detajueshëm nga Ekzekutivi i Komunës, që ka ardhur në këtë përfundim, andaj ju lusim që ta mbështesni.

Afrim Dumani: Faleminderit Kryesues i Kuvendit të Komunës, unë pata një pyetje për Drejtorin e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, nuk ka ardhur askush në fshatin Miradi e Poshtme, për t'i pyetur banorët dhe askush nga banoret nuk dinë asgjë për këtë punë, na keni anashkaluar si banorë të fshatit, sepse kjo pronë evidentohet si pronë e fshatit.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Rreth çështjes së pronës, e kemi edhe z. Valentin Krasniqi në cilësinë e Udhëheqësit të Sektorit të Kadastrit, që mund të na jap sqarime dhe informata shtesë.

Valentin Krasniqi - Udhëheqës i Sektorit të Kadastrit: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Sa i përket pronës së lartpërmendur, është pronë shtetërore, e ndarë në 2 hektar e 28 ari, nuk ka asnjë pengesë ligjore apo fizike, për ta shfrytëzuar për interes publik, është propozim i mirë dhe nuk ka pengesa ligjore për ta mbështetur. Te kjo pronë posedimi i takon Komunës së Fushë-Kosovës.

Laureat Gojnovci: Tani z. Valentin Krasniqi theksoi që prona nuk ka pengesa ligjore, por a mundeni me na treguar se çka parashihet me Hartë Zonale, sepse me hartë zonale ajo pronë është zonë rekreacioni

Valentin Krasniqi - Udhëheqës i Sektorit të Kadastrit: Kjo është pronë fshati dhe i bie që përkujdeset Kuvendi Komunal për të, tek destinacioni i hartës zonale atë informacion nuk e kam,

atë e kanë Drejtoria për Planifikim Urban. Këto terme duhet të përmirësohen në të ardhmen, këtu ku shkruan fshati, duhet të bëhet pronë komunale.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Mirë, po e hedhim në votim këtë 'Propozimin për caktimin e lokacionit për objektin e Ndërmarrjes Publike Lokale - Fushë-Kosova në fshatin Miradi e Poshtme. U votua me: nëntëmbëdhjetë vota 'për', dy vota 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej njëzet e një pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave e aprovoi 'Propozimin për caktimin e lokacionit për objektin e Ndërmarrjes Publike Lokale - Fushë-Kosova në fshatin Miradi e Poshtme' dhe mori:

V E N D I M

Për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Ndërmarrjes Publike Lokale - Fushë-Kosova, në Ngastrën Kadastrale me Nr. 72514027-00196-6, me sipërfaqe S=22808m², në vendin e quajtur 'Livade-Pashnjak', posedim individual 'P.SH Fshati', në Zonën Kadastrale Miradi e Poshtme.

Pika e gjashtë (6) - Propozim për lejimin e mjeteve financiare për ndërtimin e objektit për funksionimin e Ndërmarrjes Publike Lokale - Fushë-Kosova.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Ftojme Drejtorin z. Izja Mjeku ta paraqes materialin në emër të Kryetarit të Komunës.

Drejtori për Shërbime Publike dhe Mjedis: Sikur po e shihni ky propozim është nga Kryetari i Komunës. Kryetari Komunës pas kryerjes së punëve paraprake përgatitore dhe analizimit të bazës ligjore, strukturimit të objektivave të funksionimit të Ndërmarrjes Publike Lokale – Fushë-Kosova, pastaj vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës i datës 20.02.2026, shqyrton dhe analizon mundësitë buxhetore për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej: 300,000.00€, të cilat do të merren nga rritja e të hyrave vetjake dhe bartja e tyre për shpenzime në vitin 2026, nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve Nr. 200, programi Infrastruktura Publike Nr. 18162. Strukturën dhe bazamentin e ndërtimit të projektit, do ta bëjë ekipi profesional i arkitektëve dhe inxhinierëve të komunës.

Kosovar Ademi: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të lëvizjes Vetëvendosje, e përkrahim për aprovim 'Propozimin për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej: 300,000.00€, të cilat do të merren nga rritja e të hyrave vetjake dhe bartja e tyre për shpenzime në vitin 2026' për funksionimin e ndërmarrjes publike lokale.

Laureat Gojnovci: Sipas meje kjo ndërmarrje keq është nis, keq po shkon dhe keq do të përfundojë. Drejtori i Buxhetit dhe Financave më ka mësuar kur ka qenë drejtor i Lidhjes Demokratike të Kosovës, se kur bëhet tejkalimi i të hyrave ato shpërndahen në vitin ekzistues, që i bjen të shpërndahen në vitin 2026 dhe kur kërkojshim para thojke po e hapim kodin dhe me bartje e mbushim me mjete financiare. Nuk mundeni me shpërndarë të hyra vetjake kur nuk e keni buxhetin aktual.

Migjen Kolshi: Komplet fokusi i këtij Ekzekutivi i Komunës është te ndërmarrja publike, deri tani i keni ndarë 500,000.00€, për këtë ndërmarrje edhe sa do t'i ndani deri në fundvit, kaq do t'i marrë edhe përmbauesi privat, sepse do të mbesin shumë projekte pa përfunduar.

Rrahim Tërnavë: Unë mendoj që pak është ky buxhet 300,000.00€ për ndërmarrjen publike, sepse nevojat dhe kërkesat e qytetit janë të mëdha. Qytetarët e Komunës së Fushë-Kosovës, kanë

shumë probleme dhe ndërmarrja, duhet të ndërtohet sa më parë. Po çuditem si po kritikon Lidhja Demokratike e Kosovës kur është dashur sa ka qenë në pushtet ta bëjë ndërmarrjen.

Etnik Berjani: Po çuditem edhe unë me juve, që po e kritikon Lidhjen Demokratike të Kosovës, kur na ka lavdëruar në tubime zgjedhore.

Rrahim Tërnavaj: Ka qenë fushat politike ajo, e kam pasur obligim brenda partisë dhe ju kam përmbajtur, partia është në nivel struktural të Kosovës dhe e kam obligim ta respektoj, se unë individualisht kurrë s'kam qenë me Lidhjen Demokratike të Kosovës.

Drejtori i Buxhetit dhe Financave: Përsëendetje për të gjithë, z. Laureat Gojnovci sa për informim ju vitin e kaluar keni bërë bartjen e 2 milion eurove, prej tyre 600,000.00€ i keni ridestinuuar, ndërsa 1,400,000.00€ janë të pa alokuara, tani me vendimin e Kuvendit të Komunës, ato do të mbushin kodet e programeve. Këto mjete financiare prej: 300,000.00€ shkojnë në kategorinë subvencione dhe transfere, te transferet kapitale me Ligjin për menagjimin e financave publike dhe përgjegjësi, është e lejueshme dhe me Rregulloren e Thesarit 01 dhe 02 të ndërtojmë ndërmarrjen, sepse ju keni ndërtuar me 'Voice of Rome', nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve.

Laureat Gojnovci: Drejtor tani 'Voice of Rome' është Organizatë Jo Qeveritare dhe nëse don me bërë prej subvencioneve, nëse ka qëllim humanitar, social për shoqërinë të takon, ju jeni duke dashtun me ndërtuar objekt që jeni vetë aksionar, që ka të bëjë me mirëmbajtje. Kryetari i Komunës, e ka bllokuar ndërtimin e kësaj ndërmarrje, sa ka qenë në Ministrinë e Ekonomisë, mbikëqyrës i ndërmarrjeve publike e tani po nguteni. Arsyeja e Ministrisë së Ekonomisë, ka qenë se nuk është në buxhet, e as tani nuk është në buxhet.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit, meqenëse nuk ka të tjerë po e hedhim në votim tani 'Propozimin për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej: 300,000.00€, për ndërtimin e objektit për funksionimin e Ndërmarrjes Publike Lokale - Fushë-Kosova'.

U votua me: tetëmbëdhjetë vota 'për', gjashtë vota 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej njëzet e katër pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave e aprovoi 'Propozimin për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej: 300,000.00€, për ndërtimin e objektit për funksionimin e Ndërmarrjes Publike Lokale - Fushë-Kosova' dhe mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin e Propozimit Nr. 374, të datës 06.03.2026 për lejimin e mjeteve financiare në shumë të përgjithshme prej: 300,000.00€, për ndërtimin e objektit për Ndërmarrjen Publike Lokale - Fushë-Kosova, në fshatin Miradi e Poshtme.
2. Shuma e mjeteve financiare e përshkruar në paragrafin 1, të këtij vendimi ndahet nga buxheti i Komunës së Fushë-Kosovës, kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve Nr. 200 - programi buxhetor Nr. 18162 Infrastruktura Publike dhe ka për qëllim ndërtimin e objektit për Ndërmarrjen Publike Lokale - Fushë-Kosova, nga burimet e financimit prej bartjes së mjeteve financiare nga buxheti i komunës për vitin 2026 dhe rritja e të hyrave vetjake e vitit 2025, të bartura për shpenzim në vitin 2026.

Pika e shtatë (7) - Propozim për shqyrtimin e Bashkëpunimit operacional për Ndërmarrjen Publike Lokale - Fushë-Kosova dhe shërbime tjera me UNDP- në.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Fjala prapë është për Drejtorin z. Izja Mjeku.

Drejtori për Shërbime Publike dhe Mjedis: Pra sikur po e shihni edhe në material ky është propozim i Kryetarit të Komunës, për shqyrtimin e Bashkëpunimit operacional për Ndërmarrjen Publike Lokale - Fushë-Kosova dhe shërbime tjera me UNDP-në. Kryetari i Komunës për kryerjen e punëve paraprake përgatitore dhe analizimit të bazës ligjore, strukturimit të objekteve të funksionimit të Ndërmarrjes Publike Lokale - Fushë-Kosova, pastaj me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, i datës 20.02.2026, krijimit të infrastruktures ligjore dhe sociale, lejimit të kapitalit fillestar prej: 10,000.00€, lejimit të mjeteve financiare për funksionim gjatë vitit 2026, do prej: 190,000.00€ nga buxheti i komunës, emërimit të komisionit komunal të aksionarëve, punës për caktimin e lokacionit dhe ndërtimin e objektit, propozon që të merret një vendim për blerjen e paisjeve për funksionimin e ndërmarrjes në bashkëpunim me UNDP-në. Blerja e këtyre pasijeve e vënë në funksion operativ Ndërmarrjen Publike Lokale - Fushë-Kosova, strukturën e këtyre pajisjeve, që duhet të blihen për ndërmarrjen publike dhe shërbime tjera komunale, do të ju caktohet një komision i specializuar i caktuar nga ana e Kryetarit të Komunës, në bashkëpunim reciprok me përfaqësuesit e UNDP-së, duke caktuar formën e bashkëpunimit mes Komunës së Fushë-Kosovës dhe UNDP-së, për periudhën e ardhshme.

Kosovar Ademi: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lëvizjes Vetëvendosje, e mbështesim për aprovim 'Propozimin për shqyrtimin e Bashkëpunimit operacional për Ndërmarrjen Publike Lokale - Fushë-Kosova dhe shërbime tjera me UNDP-në.

Laureat Gojnovci: Ky propozim duhet të bëhet pasi që të funksionalizohet ndërmarrja, kjo letër me 2-3 paragrafë për ndërmarrje kaq të rëndësishme është e pamjaftueshme, pse nuk po e specifikoni me mirë çfarë do të bëni?

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Ky vendim që do e marim tani ka të bëjë me atë, që ne do të i'a lejojmë komunës dhe UNDP-së, që të bëjnë marrëveshjen për blerjen e paisjeve gjithëpërfshirëse.

Rrahim Tërnavë: Me pëlqen kjo marrëveshje me UNDP-në, sepse është një kontroll, që të shkojnë gjërat më korrekt, andaj ju përgëzoj.

Driton Ademi: Aq sa kuptova nga sqarimi i drejtorit, ky propozim ka të bëjë me fillimin e procedurave për blerjen e paisjeve në bashkëpunim me UNDP-në, kjo marrëveshje e shkruar ka me ardhur në Kuvendin e Komunës, çfarë do forme e bashkëpunimit nuk duhet me lejuar me qenë në proces të vendim marrjes brenda ndërmarrjes, sepse e cënon atë që ndërmarrja është aksionare.

Valon Murseli: Procedurat për blerjen e paisjeve kush do t'i ndjek?

Jetmir Berisha: Ndërmarrja duhet të zhvilloi procedurat, sepse e ka prokurimin e vet, pastaj shkojmë nga ana ligjore e procedurave.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: UNDP-ja dhe Komuna e Fushë-Kosovës bëjnë marrëveshjen edhe për shërbime tjera, edhe të ndërmarrjes, sepse është me bashkëfinancim, po e hedhim në votim tani 'Propozimin për shqyrtimin e Bashkëpunimit operacional për Ndërmarrjen Publike Lokale - Fushë-Kosova dhe shërbime tjera me UNDP-në'.

U votua me: nëntëmbëdhjetë vota 'për', dy vota 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej njëzet e një pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave e aprovoi 'Propozimin për shqyrtimin e Bashkëpunimit operacional për Ndërmarrjen Publike Lokale - Fushë-Kosova dhe shërbime tjera me UNDP-në' dhe mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin e Propozimit Nr. 375, të datës 06.03.2026 ndërmjet Komunës së Fushë-Kosovës dhe Organizatës së Kombeve të Bashkuara - UNDP-së, për shërbimet komunale që realizohen nga Drejtoritë e Komunës së Fushë-Kosovës dhe Ndërmarrja Publike Lokale - Fushë-Kosova.
2. Korniza bazë e bashkëpunimit operacional për shërbime në interes të komunitetit lokal, definohet me lidhjen e 'Marrëveshjes së Bashkëpunimit nga Kryetari i Komunës së Fushë-Kosovës dhe përfaqësuesve të UNDP-së', për blerjen e pajisjeve të ndryshme për kryerjen e shërbimeve publike komunale, me interes publik në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.

Pika e tetë (8) - Propozim për ndërrimin e destinimit të objektit shëndetësorë në fshatin Graboc i Poshtëm.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Fjala për Drejtorin e Drejtorisë së Arsimit z. Adriatik Zeqiri që të na jap sqarime lidhur me propozimin në fjalë. Hap diskutimin.

Drejtori për Arsimit: Duke u bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, e paraqesim për shqyrtim dhe miratim 'Propozimin për ridestinimin e objektit shëndetësor në fshatin Graboc i Poshtëm, objekti është ndërtuar për të ofruar shërbime shëndetësore dhe tani është jashtë funksionit, për arsye të kërkesave jo të mjaftueshme për shërbimet për të cilat është destinuar që t'i ofroj. Nga ana tjetër bazuar në vlerësimet e bëra nga Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Drejtoria e Shëndetësisë është vlerësuar se ekziston nevoja për zgjerimin e shërbimeve edukative në fëmijerin hershme në këtë lokalitet, për këtë arsye konsiderohet e nevojshme që objekti në fjalë të ridestinohet në funksionim si institucion parashkollor. Ridestnimi i këtij objekti do të mundësonte që një komunitet të përfitonte disa shërbime, që janë shumë të nevojshme, andaj propozojmë që Kuvendi i Komunës të miratojë vendimin për ridestinimin e objektit nga Ambulanca e Mjekësisë Familjare në institucion parashkollor, si dhe të autorizoj organet kompetente komunale për ndërmarrjen e hapave të mëtejshme administrativ dhe teknik, sipas destinimit të ri.

Kosovar Ademi: Ajo zonë ka nevojë për çerdhe të fëmijëve, kështu që ne e përkrahim për aprovim ridestinimin e propozuar.

Jetmir Berisha: Sa i përket këtij propozimi unë edhe në mandatin e kaluar nuk e kam përkrah me u ndërruar destinimi i ambulantës, jeta dinamike të rinjë të angazhuar me punë të tyre dhe aty ka shumë të moshuar që kanë nevojë për shërbimet e ambulantës. Nuk jam kundër çerdhes së fëmijëve, numri i fëmijëve është shumë i vogël për parashkollor i presim vetëm tre fëmijë. Prona ka qenë e një banori që e ka dhuruar për ndërtimin e ambulantës, ne kemi shkollën që keni mundur dhe aty me bërë zgjidhje, çerdhe nuk ka as në fshatin Bardhi i Madh, që është fshati me i madh në Kosovë, unë mendoj që ai objekt të funksionalizohet për ambulantë dhe të ju ofrohen shërbime atyre banorëve.

Dardane Sogojeva Shala: Faleminderit Kryesues i Kuvendit të Komunës, unë nuk jam kundër çerdhes së fëmijëve, por a mundet me na sqaruar Drejtori për Arsim, a është pronë e komunës, apo pronë private, me sa e di unë prona është private dhe nevoja është më e madhe për Ambulancë të Mjekësisë Familjare, se sa për çerdhe të fëmijëve. Dje në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, e kemi hjek propozimin për Nakaradë që ka qenë, tani drejtor tu kisha lutur rishikoje sepse kopshti bashkangjitur me varreza është gabim. Është mirë që ajo pjesa që është kërkuar për kopshtë të fëmijëve, aty të zgjerohen varrezat.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani po e hedhim në votim tani 'Propozim për ndërrimin e destinimit të objektit shëndetësorë në objekt për Çerdhe të Fëmijëve në fshatin Graboc i Poshtëm'. U votua me: shtatëmbëdhjetë vota 'për', tetë vota 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej njëzet e pesë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje. Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave e aprovoi 'Propozimin për ndërrimin e destinimit të objektit shëndetësorë në objekt për Çerdhe të Fëmijëve në fshatin Graboc i Poshtëm' dhe mori:

V E N D I M

Për aprovimin e Propozimit për Ri-destinimin e shfrytëzimit të objektit të Ambulancës së Mjekësisë Familjare në fshatin Graboc i Poshtëm, në objektin për Institucionin Parashkollor - Çerdhes së Fëmijëve.

Pika e nëntë (9) - Propozim për lirimin nga pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në jo bujqësore për projektet publike komunale.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani e ftojme Drejtorin e Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, që ta paraqes propozimin.

Drejtori për Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural: Faleminderit Kryesues i Kuvendit të Komunës, materialin e keni parë bëhet fjalë për objektet në pronësi të komunës me interes publik, e që për t'i ndërtuar ligjërisht pas kushteve ndërtimore vjen në Drejtorinë e Bujqësisë, ku bëhet shkëmbimi i pronës nga bujqësore në jo bujqësore dhe duhet të kryhet një pagesë, duke i parë rrethanat besoj se ky propozim duhet të kaloj, sepse do të shërbej edhe në të ardhmen.

Kosovar Ademi: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lëvizjes Vetëvendosje, e përkrahim për aprovim këtë propozim.

Laureat Gojnovci: Faleminderit Kryesues i Kuvendit, e kemi të pa qartë këtë propozim dhe do të abstenojmë.

Migjen Kolshi: Sa i përket kësaj pike edhe ligji e jep ashtu, është në të mirën e komunës.

Driton Ademi: Neni 14 i Ligjit për Tokën Bujqësore, është shumë i qartë se duhet të ridestinohet, është fakti që këto mjete financiare, e kanë prapë një destinim specifik që përdoren kur është shfrytëzimi i tokës. Duke pasur parasysh atë që e tha drejtori një konsultë me Ministrinë e Bujqësisë, atëherë e marrim si të kryme për ndyshe neni 14, është specifik nuk besoj që na lejon këtë lloj ndërrimi të destinimit.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Ideja nuk është me bërë ndërrimin e destinimit të tokës, por vetëm lirimin nga pagesa, po drejtor.

Drejtori për Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural: Pajtohem me mendimin e z. Driton Ademi, që specifikat janë krijuar që të ruhet toka bujqësore, mirëpo ne nuk po flasim për pjesën, a duhet me u ruajtur apo jo, ne po flasim për lirim nga pagesa për një listë gjërash.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani po e hedhim në votim tani 'Propozimin për lirimin nga pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në jo bujqësore për projektet publike komunale'.

U votua me: njëzet vota 'për', asnjë vota 'kundër' dhe gjashtë abstenime, gjithsej njëzet e gjashtë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave e aprovoi 'Propozimin për lirim nga pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në jo bujqësore për projektet publike komunale' dhe mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin e Propozimit Nr. 235, të datës 05.03.2026, për lirim nga pagesat e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokave bujqësore, në toka jo bujqësore, në interes të kryerjes së procedurave administrative për realizimin e projekteve kapitale publike të financuara nga buxheti i komunës, niveli qendror dhe donatorët e ndryshëm vendor dhe ndërkombëtarë në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.
2. Pagesa e kompensimit nuk do të bëhet për projektet kapitale tjera me interes publikë, të cilat nuk janë të radhitura në nenin 14, paragrafi 3 dhe paragrafi 4, të Ligjit Nr. 02/L-26, meqë kategoritë e përshkruara në këtë nen janë të kufizuara, ndërsa projektet kapitale janë të shumta, edhe në fusha tjera të zhvillimit të komunës.

Pika e dhjetë (10) - Propozim për caktimin e anëtarëve të Komisionit Komunal për emërtimin e rrugëve.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Atëherë po shkojmë direkt te emrat të cilat unë do t'i lexoi tani është: Taulant Kelmendi - Drejtor për Planifikim Urban - Kryesues i Komisionit, Izja Mjeku - Drejtor për Shërbime Publike dhe Mjedis, Ejup Qyqalla - Udhëheqës i Sektorit për Shërbime Publike, Vlonjat Hasani - Kryesues i Kuvendit të Komunës, pastaj do t'i marrim emërat e tri subjekteve më të mëdha politike të përfaqësuara në Kuvendin e Komunës.

Besarta Qadraku: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lëvizjes Vetëvendosje, e propozojmë për anëtarë të Komisionit për emërimin e rrugëve z. Hajredin Mjeku.

Laureat Gojnovci: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, e propozojmë për anëtarë të Komisionit për emërimin e rrugëve z. Jetmir Berisha.

Migjen Kolshi: Unë si Shef i Grupit Parlamentarë të Partisë Demokratike të Kosovës, e propozoj znj. Aida Alimi.

Rrahim Tërnavë: Unë propozoj z. Ermal Dumani.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit, unë po i lexoj emrat e ekspertave të jashtëm: Ahmet Grajçevci, Asllan Qyqalla, Ramiz Zeqiri, Haxhere Gerguri Berisha, ndërsa nga Shoqëria Civile Sadik Konjusha.

Driton Ademi: Nuk emërohet një rrugë pa nënshkrime, një historiat të atij emri dhe nuk emërohet rruga në qoftëse janë me pak se 10 shtëpi dhe nuk ka emërtime me emra të njejtë, komisioni e kryen punën e vet, i bjen emrat në kuvend dhe kuvendi i miraton.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Po vazhdojmë me votim me emra veç e veç si vijon: Taulant Kelmendi - 18, Izja Mjeku - 27, Ejup Qyqalla - 27, Vlonjat Hasani - 26, Hajredin Mjeku - 27, Jetmir Berisha - 27, Aida Alimi - 8, nuk kalon, Ermal Dumani - 24, Ahmet Grajçevci, Asllan Qyqalla, Ramiz Zeqiri, Haxhere Gerguri Berisha dhe Sadik Konjusha - ekspertat si pako në votim - 27.

Dardane Sogojeva Shala: Deshta të pyes pse janë dy anëtar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, pse mos të hynë Drejtori për Arsim dhe Drejtori për Infrastrukturë, që duhet me qenë pjesë e këtij Komisioni.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: pas sqarimeve e konstatojmë se është formuar ky komision në përbërjen e votuar më lartë dhe mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin e Propozimit për caktimin e anëtarëve të Komisionit Komunal për emërtimin e rrugëve në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, në përbërje prej dymbëdhjetë anëtarëve si vijon:
 - 1.1 Taulant Kelmendi - Drejtor për Planifikim Urban - Kryesues i Komisionit;
 - 1.2 Izja Mjeku - Drejtor për Shërbime Publike dhe Mjedis, anëtar;
 - 1.3 Ejup Qyqalla - Udhëheqës i Sektorit për Shërbime Publike, anëtar;
 - 1.4 Vlonjat Hasani - Kryesues i Kuvendit të Komunës, anëtar;
 - 1.5 Hajredin Mjeku - përfaqësues nga Lëvizja Vetëvendosje, anëtar;
 - 1.6 Jetmir Berisha - përfaqësues nga Lidhja Demokratike e Kosovës, anëtar;
 - 1.7 Ermal Dumani - përfaqësues nga Partia Demokratike e Kosovës, anëtar;
 - 1.8 Ahmet Grajçevci - ekspert i jashtëm, anëtar;
 - 1.9 Asllan Qyqalla - ekspert i jashtëm, anëtar;
 - 1.10 Ramiz Zeqiri - ekspert i jashtëm, anëtar;
 - 1.11 Haxhere Gërguri Berisha, eksperte e jashtme, anëtare dhe
 - 1.12 Sadik Konjusha - përfaqësues i Shoqërisë Civile, anëtar.
2. Detyrë dhe përgjegjësi e anëtarëve të Komisionit Komunal për emërtimin e rrugëve , është puna në përgatitjen e listës rezervë të rrugëve dhe emërtimi i rrugëve të reja, aty ku plotësohen kriteret e caktuar me Ligjin për evidentimin e adresave.

Pika e njëmbëdhjetë (11) - Propozim për shqyrtimin e raportit të Komisionit Komunal për vërshimet e muajit janar 2026.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani unë e kam një sqarim për koleget asambleistë, materiali që ju ka ardhur janë të dhënat personale të disa përfituesëve dhe ju lutem të mos i shpërndani këto të dhëna, sepse mund të penalizohen me ligjin e privatësisë.

Drejtori për Shërbime Publike dhe Mjedis: Pas përfundimit të vërshimeve në muajin janar, ne si drejtori së bashku me Kryetarin e Komunës, e kemi formuar komisionin prej pesë anëtarëve për evidentimin dhe regjistrimin e dëmeve. Bazuar në vendimin Nr. 19, të datës 09.01.2026 për formimin e Komisionit për vlerësimin e dëmeve në Komunën e Fushë-Kosovës, me datë 16.01.2026, komisioni sipas kërkesave të cilat janë bërë në zyrën pritese në Komunën e Fushë-Kosovës, kanë dalur në terren për vlerësimin dhe verifikimin e dëmeve të shkaktuara nga kjo fatëkeqësi dhe është konstatuar kjo gjendje, gjithsej kanë qenë 309 kërkesa, dëmet në ekonomi familjare 276 kërkesa brenda dhe jashtë afatit ligjor, prej tyre 37 janë të refuzuara. Kostoja totale e dëmeve në ekonomi është 121,660.40€. Dëmet në biznese nga 13 kërkesa Brenda dhe jashtë afatit ligjor, prej tyre 8 janë kërkesa të refuzuara dhe cmimi total është 10,244.00€. Dëmet në ekonomi familjare nga 16 kërkesa gjithsej jashtë afatit për aplikim prej tyre 2 kërkesa janë të refuzuara, cmimi total është 3,865.15€. Dëmet në bujqësi nga 21 kërkesa prej tyre 9 janë kërkesa të refuzuara, ndërsa cmimi i dëmeve është 8,506.50€. Konkuldim: dëmet në ekonomi familjare, biznese, kultura bujqësore brenda afatit ligjor për aplikim kapin vlerën prej: 140,410.90€. Shuma

totale për të gjitha këto 309 kërkesa është 140,410.90€, raport i cili do t'i dorëzohet Qeverisë së Kosovës.

Kosovar Ademi: Nuk kemi të shtojmë asgjë, pajtohemi që ky Raport i Komisionit për vlerësimin e dëmeve të aprovohet dhe të dërgohet në Qeverinë e Kosovës, për realizim në interesin e qytetarëve të komunës tonë.

Laureat Gojnovci: E vlerësoj drejtor që e keni sjellë këtë raport, edhe pse nuk keni qenë të obliguar.

Drejtori për Shërbime Publike dhe Mjedis: Ne kemi pasur një takim me Komisionin Qeveritar i cili ka ardhur, ata na kanë obliguar që raporti të shqyrtohet dhe aprovohet në Kuvendin e Komunës.

Migjen Kolshi: Drejtor të përgëzoj për këtë raport, deshta të lidhem me kohën e vërshimeve, pse nuk e keni bërë publike, a ka pasur ndihmë gjatë vërshimeve nga bizneset, sepse nuk e keni bërë një raport të rregullt për shpenzimet që i keni bërë. Edhe diçka tjetër e keni ekzagjeruar shumë, në mbrëmje keni dalur në teren, ku Kryetari i Komunës, me qizme të verdha të tjerët në patike, nesër në mëngjes Nënkryetari i Komunës me qizme, në mbrëmje Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, me paketa, duke i nxjerr prej kombit, tjetri me bidon të ujit, pas tre ditëve edhe drejtori z. Izja Mjeku me qizme të verdha e bëri një foto në Graboc të Poshtëm, krejt me një palë qizme.

Drejtori për Shërbime Publike dhe Mjedis: Migjeni ka të drejtë, sepse kemi pasur shumë donacione gjatë vërshimeve, ne ju kemi dhënë një raport pranim-dorëzim i mallit, uji 'Lajthiza' i ka dhuruar dikun 6000 litra, Interexi 2000 litra, Shoqata 'Bereqeti' 700 litra e tjera. Ka pasur shumë donacione që i falënderojmë dhe i kemi falënderuar përmes mjeteve të informimit. Sa i përket qizmeve Migjen, komuna veç një palë qizme i ka pasur.

Dardane Sogojeva Shala: Drejtor të falënderoj për punën, që e keni bërë gjatë vërshimeve dhe deshta të pyes, pse asnjë anëtar i Kuvendit të Komunës, nuk ka qenë në komision të dëmeve? Në raport e pashë një vlerësim dëmi 125 euro, nuk e di çfarë dëmi ka qenë, përderisa në raport janë të dhënat personale, pse nuk ka foto ku i keni vlerësuar.

Drejtori për Shërbime Publike dhe Mjedis: Për të dhënat personale të përfituesve është bërë një lëshim, ndërsa fotot mundeni t'i ose kushdo që dëshiron me ardhur në zyre me i parë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Nëse nuk ka dikush tjetër të shtojë diçka, po e hedhim në votim 'Raportin e Komisionit Komunal për kompesimin e dëmeve nga vërshimet e muajit janar 2026'.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e një anëtarë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se me unanimitet të votave të pjesëmarrësve në votim aprovohet 'Raportin e Komisionit Komunal për kompesimin e dëmeve nga vërshimet e muajit janar 2026' dhe mori:

V E N D I M

1. Me këtë vendim, në përputhje me nenin 31, paragrafi 1.1 të Rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Nr. 17/2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera, propozohet miratimi i Raportit përfundimtar të përshkruar sipas Procesverbalit Nr. 164, të datës 16.02.2026, të Komisionit Komunal për Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera.

2. Me miratimin e këtij Vendimi nga Kuvendi i Komunës, konfirmohet vlerësimi i dëmeve në shumën totale të mjeteve financiare prej: 140,410.90€, të ndara si në vijim: 121,660.40€ për dëme në ekonomi familjare; 10,244.00€ për dëme në biznese; 8,506.50€ për dëme në bujqësi dhe dëmet tjera në ekonomi familjare, biznese dhe kultura bujqësore, të trajtuara pas aplikimit të caktuar nga komuna, është në shumën e mjeteve financiare prej: 3,336.15€.

Pika e dymbëdhjetë (12) - Raporti i Punës së Kuvendit të Komunës në vitin 2025.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Është materiali i herës së kaluar nevojitet për performancë, janë statistika të vitit të kaluar dhe nevojiten t'i kemi për analiza të punës një vjeçarë.

Pika e trembëdhjetë (13) - Rishqyrtimi i vendimit Nr. 17, për shfrytëzimin e Zyrës Sektoriale për Stacionin e Policisë së Fushë Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Po e hapim në rishqyrtim këtë material, tani Kryetari i Komunës në përputhje me nenin 40, paragrafi 40.3, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, neni 27, të Statutit të Komunës me Nr. 98, të datës 17.08.2012, për të zgjidhur çështjen e mbetur pezull nga periudha e kaluar, duke rezervuar të drejtën për marrjen e një pëlqim të përkohëshëm të këtij objekti brenda vitit 2026, me qenë se ambulanta është ndërtuar në pronën e mengjuar nga Agjensia Kosovare e Privatizimit para më shumë se dhjetë viteve. Propozimit i bashkangjitet dokumentacioni përcjellës, për vlerësimin e ligjshmërisë së ardhur nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe vendimin e Kuvendit të Komunës, në kompetenca për menagjimin e kësaj prone, u'a delegojmë Kryetarit të Komunës, pastaj ai me mekanizmat e tij, e merr pronën dhe e jep në shfrytëzim për Stacionin e Policisë, pasi të merr pëlqimin nga Agjensia Kosovare e Privatizimit. Kosovar Ademi: Në emër të anëtarëve të Grupit parlamentarë të Lëvizjes Vetëvendosje, e përkrahim propozimin për delegimin e kompetencave për Kryetarin e Komunës, për marrjen e pëlqimit nga Agjensia Kosovare e Privatizimit për shfrytëzim të kësaj prone.

Laureat Gojnovci: Unë mendoj që jeni i obliguar me hedh në votim, jo për t'i deleguar Kryetarit të Komunës, por për shfuqizim, ne nuk e kemi përkrah në mbledhjen e parë dhe sot do të votojmë për ta shfuqizuar, pasi që është kthyer si i kundërligjshëm nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Migjen Kolshi: Njëjtë mendojmë edhe unë sikur parafolësi im Laureati.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Materiali thotë nga rekomandimet e Ministrisë, e para na ka dhënë rekomandim për rishqyrtim, tani Komuna e Fushë-Kosovës, duhet të filloj procedurat për bartjen e pronës sikur e cakton ligji për pronat publike, pastaj vazhdon me dhënien e pronës për institucionet e tjera. Kështu ne po veprojmë, jemi duke e rishqyrtuar dhe po i'a delegojmë Kryetarit të Komunës dhe ai e rregullon me mekanizmat e vet.

Laureat Gojnovci: Ju ose e mbani, ose nuk e mbani në fuqi këtë vendim, do të ishte mirë që ky vendim të shfuqizohet sot.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Ne po e delegojmë kompetencën te Kryetari i Komunës, sepse kemi të drejtë si Kuvend, pastaj Agjensia Kosovare e Privatizimit, a lejon apo jo është çështje tjetër, këtë e hedhim në votim.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej gjashtëmbëdhjetë anëtarë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se me unanimitet të votave të pjesëmarrësve në votim aprovohet 'Propozimi për ndryshim-plotësim dhe delegimin e kompetencës të Kryetari i Komunës, për marrjen e pëlqimit nga Agjensia Kosovare e Privatizimit për shfrytëzimin e kësaj prone' dhe mori:

V E N D I M

1. Për ndryshimin e paragrafit një (1) të vendimit Nr. 18, të datës 28.01.2026, për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme për Zyrë Sektoriale për nevojat e Stacionit të Policisë në Fushë-Kosovë, në lagjen Dardania të banesat e Kompleksi 300 në rrugën 'Ago Imeri' në Fushë-Kosovës si vijon:
2. Delegimin e kompetencave dhe bartjen e tyre nga Kuvendi i Komunës, të Kryetari i Komunës, për kryerjen e procedurave për marrjen e 'Pëlqimit për shfrytëzim të përkohshëm të kësaj prone të Agjencisë Kosovare të Privatizimit', për shfrytëzimin e përkohshëm një vjeçar të këtij objekti publik të ndërtuar para më shumë se dhjetë viteve për Zyrë Sektoriale për Policinë e Kosovës në Fushë-Kosovës.

Pika e katërmëdhjetë (14) - Propozimi për caktimin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Fushë Kosovës për Projekt-Rregulloret Komunale.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Ju lutem shikoni rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, ne i kemi rritur opsionet për subjektet e tjera politike, në mënyrë që të përfshihen të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës. Në Grupin Punues të Rregullorës për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha: tre anëtarë janë nga Lëvizja Vetëvendosje, tre anëtarë nga Lidhja Demokratike e Kosovës dhe dy anëtarë nga Partia Demokratike e Kosovës. Në Grupin Punues të Rregullores për Subvencione: një anëtar nga Partia Demokratike e Kosovës, po ashtu shtohet edhe një nga subjektet e tjera politike. Në Grupin Punues të Rregullores për Këshillat e Lagjeve Urbane dhe Fshatrave, shtohet një anëtar nga subjektet e tjera politike.

Besarta Qadraku: Propozimet tona për rregulloren e taksave janë: Arlinda Mekolli, Kosovare Ademi dhe Besarta Qadraku.

Laureat Gojnovci: Propozimet tona për rregulloren e taksave janë: Etnik Berjani, Jetmir Berisha dhe Burim Berisha.

Migjen Kolshi: Propozimet tona për rregulloren e taksave janë: Aida Alimi dhe Migjen Kolshi.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit, tani Driton Ademi në këtë rregullore nga subjektet e tjera. Te Projekt-Rregullorja për shfrytëzimin e Hapësirave Publike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.

Besarta Qadraku: Kushtrim Mirena dhe Filloreta Musaj.

Laureat Gojnovci: Afrim Dumani dhe Mirlinda Krasniqi.

Migjen Kolshi: Valon Murseli.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Te subjektet e tjera znj. Vildane Latifi. Projekt-Rregullorja për kushte, kritere dhe procedura për ndarjen e subvencioneve, të tjerët propozohen.

Besarta Qadraku: Festim Pllana dhe Rrahim Sogojeva.

Laureat Gojnovci: Ali Topalli dhe Vjosa Kida.

Dardane Sogojeva Shala: Rrahim Tërnavë dhe Dardane Sogojeva Shala.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit, nga subjektet e tjera z. Ali Ismaili dhe Suhat Ademi. Projekt-Rregullorja për këshillat e lagjeve urbane dhe fshatrave në territorin e Komunës së Fushë Kosovës.

Besarta Qadraku: Hajredin Mjeku dhe Daut Krasniqi.

Laureat Gojnovci: Saranda Sllamniku dhe Laureat Gojnovci.

Dardane Sogojeva Shala: Ermal Dumani.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Te subjektet e tjera Radoman Doderovic dhe Dashnim Bajrami. Me të gjitha këto propozime po e hedhim në votim tani.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e pesë anëtarë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se me unanimitet të votave të pjesëmarrësve në votim aprovet 'Propozimi për për caktimin e anëtarëve të Grupeve Punuese për përgatitjen e katër Projekt-Rregulloreve Komunale, me emrat e cekur më lartë' dhe mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin e Propozimit për caktimin e anëtarëve të Grupeve Punuese për përgatitjen e katër Projekt-Rregulloreve Komunale si vijon:
 - 1.1 Projekt-Rregullorja për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale:
 - 1.1.1 Arlinda Mekolli - përfaqësuese nga Lëvizja Vetëvendosje, anëtare;
 - 1.1.2 Kosovar Ademi - përfaqësues nga Lëvizja Vetëvendosje, anëtar;
 - 1.1.3 Besarta Qadraku - përfaqësues nga lëvizja Vetëvendosje, anëtare;
 - 1.1.4 Etnik Berjani - përfaqësues i Lidhjes Demokratike e Kosovës, anëtar;
 - 1.1.5 Jetmir Berisha - përfaqësues i Lidhjes Demokratike të Kosovës, anëtar;
 - 1.1.6 Laureat Gojnovci - përfaqësues i Lidhjes Demokratike të Kosovës, anëtar;
 - 1.1.7 Aida Alimi - përfaqësues i Partisë Demokratike të Kosovës, anëtare;
 - 1.1.8 Migjen Kolshi - përfaqësues i Partisë Demokratike të Kosovës, anëtar dhe
 - 1.1.9 Driton Ademi - përfaqësues i Nismës Socialdemokrate, anëtar.
 - 1.2 Projekt - Rregullorja për shfrytëzimin e hapësirave publike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës:
 - 1.2.1 Kushtrim Mirena - përfaqësuese nga Lëvizja Vetëvendosje, anëtar;
 - 1.2.2 Filloreta Musaj - përfaqësuese nga Lëvizja Vetëvendosje, anëtare;
 - 1.2.3 Afrim Dumani - përfaqësues i Lidhjes Demokratike e Kosovës, anëtar;
 - 1.2.4 Mirlinda Krasniqi - përfaqësuese e Lidhjes Demokratike e Kosovës, anëtare;
 - 1.2.5 Valon Murseli - përfaqësues i Partisë Demokratike të Kosovës, anëtar dhe
 - 1.2.6 Vildane Latifi - përfaqësuese e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, anëtare.
 - 1.3 Projekt - Rregullorja për kushtet kriteret dhe procedurat për ndarjen e subvencioneve:
 - 1.3.1 Festim Pllana - përfaqësues nga Lëvizja Vetëvendosje, anëtar;
 - 1.3.2 Rrahim Sogojeva - përfaqësues nga Lëvizja Vetëvendosje, anëtar;
 - 1.3.3 Ali Topalli - përfaqësues i Lidhjes Demokratike e Kosovës, anëtar;
 - 1.3.4 Vjosa Kida Hyseni - përfaqësuese e Lidhjes Demokratike e Kosovës, anëtare;
 - 1.3.5 Rrahim Tërnavë - përfaqësues i Partisë Demokratike të Kosovës, anëtar;
 - 1.3.6 Dardane Sogojeva Shala - përfaqësuese i Partisë Demokratike të Kosovës, anëtare;
 - 1.3.7 Ali Ismaili - përfaqësues nga Zëri i Drejtësisë, anëtar dhe
 - 1.3.8 Suhat Ademi - përfaqësues i Partisë Liberale Egiptiane, anëtar.
 - 1.4 Projekt - Rregullorja për Këshillat e lagjeve urbane dhe fshatrave në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës:

- 1.4.1 Hajredin Mjeku - përfaqësues nga Lëvizja Vetëvendosje, anëtar;
 - 1.4.2 Daut Krasniqi - përfaqësues nga Lëvizja Vetëvendosje, anëtar;
 - 1.4.3 Saranda Sllamniku - përfaqësuese e Lidhjes Demokratike e Kosovës, anëtare;
 - 1.4.4 Burim Berisha - përfaqësues i Lidhjes Demokratike e Kosovës, anëtar;
 - 1.4.5 Ermal Dumani - përfaqësues i Partisë Demokratike e Kosovës, anëtar
 - 1.4.6 Dashnim Bajrami - përfaqësues i Partisë Demokratike të Kosovës, anëtar dhe
 - 1.4.7 Radoman Doderovic - përfaqësues i Listës Serbe, anëtar.
2. Detyrë dhe përgjegjësi e anëtarëve të Grupeve Punuese është puna në përgatitjen e Projekt Rregulloreve Komunale, të evidentuara në paragrafin një (1) të këtij vendimi.

Pika e pesëmbëdhjetë (15) - Shqyrtimi i parë i Projekt-Planit Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore për vitet 2026 - 2028.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Fjala është për znj. Lendita Dervisholli Prebreza.

Lendita Dervisholli Prebreza: Përshëndetje për të gjithë, plani lokal i veprimit për barazi gjinore, është obligim që del nga Ligji për Barazi Gjinore, komuna ka obligim të hartoj planet e veprimit, ku janë paraparë aktivitetet që kanë për qëllim barazin gjinore, fuqizimin e pozitës së gruas në përgjithësi. Presim mbështetje dhe bashkëpunim për të dërguar para agjendës së barazisë gjinore.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Po e hapim diskutimin nëse dikush ka diçka për të shtuar, tani po e hedhim në votim për aprovimin në parim për procedurën e diskutimit publik 'Projekt-Planit Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore për vitet 2026 - 2028'.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e shtatë anëtarë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se me unanimitet të votave të pjesëmarrësve në votim aprovohet në parim për procedurën e diskutimit publik 'Projekt-Planit Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore për vitet 2026 - 2028' dhe mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin në parim për kalimin në procedurën e diskutimit publik të 'Projekt-Planit të Veprimit për Barazi Gjinore për vitet 2026-2028 në Komunën e Fushë-Kosovës'.
2. Projekt-Plani i Veprimit për Barazi Gjinore për vitet 2026-2028 në Komunën e Fushë Kosovës, i cekur në paragrafin 1 të këtij vendimi, parasheh zbatimin nga institucionet komunale të programeve, punëve dhe aktiviteteve për barazi gjinore.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është 'Projekt-Plani i Veprimit për Barazi Gjinore për vitet 2026-2028 në Komunën e Fushë-Kosovës'.

Pika e gjashtëmbëdhjetë (16) - Propozim për miratimin e zgjerimit të projektit për instalimin e pompave termike në institucionet edukativo-arsimore në Komunën e Fushë-Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Fjala është për Drejtorin e Drejtorisë së Arsimit z. Adriatik Zeqiri.

Drejtori për Arsim: I nderuar Kryesues i Kuvendit të Komunës, të nderuar/a, asambleistë, në planifikimin buxhetor për vitin 2026-2027 dhe 2028, është një planifikim për instalimin e pompave termike, në institucionet edukativo-arsimore dhe sipas vlerësimeve të buxhetit kemi mundësi të zgjerojmë këtë projekt dhe t'i përfshirë të gjitha institucionet shkollare në komunën tonë. Kërkoj nga ju që ta shfrytëzojmë mundësinë për realizimin e këtij projekti dhe t'i largojmë përgjithmonë kalldajat me dru prej shkollave tona dhe të kalojmë në eficiencë pasi që buxheti është.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit shumë drejtor, e hapi diskutimin tani.

Kosovar Ademi: Është nevojë gjenerale për renovimin e nxemjeve në shkolla, është projekt i mirë dhe ne e përkrahim.

Laureat Gojnovci: Sa i përket këtij propozimi në parim jemi për, kodi 20866 është nga Ekzekutivi i kaluar, pra ne e kemi vendosur në buxhet, drejtor kjo duhet me pasur një rishikim të buxhetit, në këto rrethana na jemi duke e modifikuar buxhetin dhe nuk mundemi me zgjeruar projektin.

Valon Murseli: A kishim mundur për këtë projekt me aplikuar në kuadër të projektit për eficiencë elektrike.

Drejtori për Arsim: Buxhet ka dhe po mendoj, që ky buxhet të shfrytëzohet për të mirë dhe kjo mund të kalohet nëpërmjet Kuvendit të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Nëse ska diskutime tjera po e hedhim në votim, kush është për 'Propozimin për miratimin e zgjerimit të projektit për instalimin e pompave termike në institucionet edukativo-arsimore në Komunën e Fushë-Kosovës'.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej gjashtëmbëdhjetë anëtarë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se me unanimitet të votave të pjesëmarrësve në votim aprovohet 'Propozimin për miratimin e zgjerimit të projektit për instalimin e pompave termike në institucionet edukativo-arsimore në Komunën e Fushë-Kosovës' dhe mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin e Propozimit Nr. 271, të datës 11.03.2026, për realizimin e zgjerimit të projektit - për instalimin e pompave termike nga kodi buxhetor Nr. 20866, për të gjitha Institucionet Edukativo-Arsimore në Komunën e Fushë-Kosovës si vijon:
 - 1.1 Shkolla Fillore e Mesme e Ulët 'Mihal Grameno' në Fushë-Kosovë;
 - 1.2 Shkolla Fillore e Mesme e Ulët 'Mihal Grameno' Aneksi 1 në Fushë-Kosovë;
 - 1.3 Shkolla Fillore e Mesme e Ulët 'Mihal Grameno' Aneksi 2 në Fushë-Kosovë;
 - 1.4 Shkolla Fillore e Mesme e Ulët 'Mihal Grameno' Cikli mësimor 1-5 në Fushë Kosovë;
 - 1.5 Shkolla Fillore e Mesme e Ulët 'Daut Bogujevci' në Fushë-Kosovë;
 - 1.6 Shkolla Fillore e Mesme e Ulët 'Selman Riza' në Fushë-Kosovë;
 - 1.7 Shkolla Fillore e Mesme e Ulët 'Laura Scotti' në fshatin Graboc i Poshtëm;
 - 1.8 Shkolla Fillore e Mesme e Ulët 'Zejnel Salihu' në fshatin Bardh i Madh;
 - 1.9 Shkolla Fillore e Mesme e Ulët 'Zejnel Salihu' Paralele e ndarë fillore në fshatin Pomozotin;
 - 1.10 Shkolla Fillore e Mesme e Ulët 'Bajram Curri' në fshatin Sllatinë e Madhe;
 - 1.11 Shkolla Fillore e Mesme e Ulët 'Bajram Curri' paralele e ndarë fillore në fshatin Henc;
 - 1.12 Shkolla Fillore e Mesme e Ulët 'Bajram Curri' paralele e ndarë fillore në fshatin Harilaç;
 - 1.13 Shkolla Fillore e Mesme e Ulët 'Vëllezërit Frashëri' në fshatin Miradi e Poshtme;
 - 1.14 Shkolla Fillore e Mesme e Ulët 'Vëllezërit Frashëri' paralele e ndarë fillore në fshatin Miradi e Epërme;
 - 1.15 Shkolla Fillore e Mesme e Ulët 'Vëllezërit Frashëri' paralele e ndarë fillore në fshatin Vragoli;
 - 1.16 Shkolla e Mesme Profesionale 'Hoxhë Kadri Prishtinë' në Fushë-Kosovë dhe

Pika e shtatëmbëdhjetë (17) - Propozim për caktimin e përfaqësuesve të Komunës së Fushë-Kosovës në Kuvendin e Asociacionit të Komunave të Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: tani duhet ta japim tre përfaqësues nga subjektet politike nga Lëvizja Vetëvendosje, Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Partia Demokratike e Kosovës, kanë nga një propozim, ju lutem t'i jepni emërat dhe t'i votojmë si pako.

Besarta Qadraku: Ne e propozojmë z. Vlonjat Hasani.

Laureat Gojnovci: Ne e propozojmë z. Jetmir Berisha.

Migjen Kolshi: Ne e propozojmë z. Valon Murseli.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Faleminderit, po i hedhim ne votim këto propozime si pako, kush është për 'Propozimin për caktimin e përfaqësuesve të Komunës së Fushë-Kosovës në Kuvendin e Asociacionit të Komunave të Kosovës', anëtarëve Vlonjat Hasani, Jetmir Berisha dhe Valon Murseli.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e shtatë anëtarë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se me unanimitet të votave të pjesëmarrësve në votim aprovohet 'Propozimin për caktimin e përfaqësuesve të Komunës së Fushë-Kosovës në Kuvendin e Asociacionit të Komunave të Kosovës', anëtarëve Vlonjat Hasani, Jetmir Berisha dhe Valon Murseli dhe mori:

V E N D I M

1. Për caktimi e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, për përfaqësim në Kuvendin e Asociacionit të Komunave të Republikës së Kosovës, për mandatin zgjedhor 2025/2029.
2. Komunën e Fushë-Kosovës në Kuvendin e Përgjithshëm të Asociacionit të Komunave të Republikës së Kosovës, do ta përfaqësojnë anëtarët si vijon:
 - 2.1 Vlonjat Hasani - Kryesues i Kuvendit të Komunës, përfaqësues i Lëvizjes Vetëvendosje, anëtar;
 - 2.2 Jetmir Berisha - Përfaqësues nga Lidhja Demokratike e Kosovës, anëtar dhe
 - 2.3 Valon Murseli - Përfaqësues nga Partia Demokratike e Kosovës, anëtar.

Pika e tetëmbëdhjetë (18) - Të Ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Anëtari jonë i ri i Kuvendit të Komunës z. Suhat Ademi bëhet anëtar i ri i Komitetit për Komunitete, duke e zëvendësuar anëtarin z. Bashkim Krasniqi. Tani e hedhim në votim

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e shtatë anëtarë pjesëmarrës në votim nga anëtarët e pranishëm.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se me unanimitet të votave të pjesëmarrësve në votim aprovohet 'Propozimi për zëvendësimin e z. Suhat Ademi me z. Bashkim Krasniqi në Komitetin për Komunitete' dhe mori:


V E N D I M

1. Për ndryshim - plotësimin e paragrafit një, nën paragrafit 1.5, të vendimit Nr. 68, të datës 24.02.2026 për themelimin e Komitetit për Komunitete, për zëvendësimin e anëtarit të deri tanishëm z. Bashkim Krasniqi nga Partia Liberale Egjiptiane, me z. Suhat Ademi - përfaqësues i komunitetit egjiptian nga Partia Liberale Egjiptiane, anëtar i Kuvendit të Komunës.
2. Detyrë dhe përgjegjësi e Komitetit për Komunitete, përgjegjësia për shqyrtimin e përputhshmërisë së autoriteteve komunale me ligjin në zbatimin dhe shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për t'iu siguruar, se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht, Komiteti gjithashtu i rekomandon Kuvendit të Komunës, masat që duhet të ndër mirren për të siguruar jetësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e komuniteteve për tu avancuar, shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor, si dhe për të siguruar mbrojtje adekuate, të drejtave të komuniteteve brenda komunës.

Me qenë se nuk ka tjera rekomandime, konstatojmë që mbledhja përfundoi, urime Festa e Fitër Bajramit, shihemi në mbledhjen e radhës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje në mbledhje. Mbledhja përfundoi në ora 15:15 minuta.

Procesmbajtës
Hasan Gjyrevci



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Vlonjat Hasani

